

**UNIVERSITETI
MJEKËSISË
TIRANË**



**FAKULTETI
SHKENCAVE MJEKËSORE
TEKNIKE**

**DISERTACION
PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR”**

***MENAXHIMI I NDERLIKIMEVE FETALE SIPAS
TREMESTRAVE TE SHTATZANISE NE SHTATZANINE
DIABETIKE PRE DHE POST DIAGNOSTIKIT TE SAJ.
INCIDENCA E TYRE NE RRETHIN E DURRESIT***

Disertanti: MIGENA PRIFTI

Udhëheqës Shkencor: Prof.Dr. Gjergj THEODHOSI

TIRANË, 2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE
DEPARTAMENTI OBSTETRIK-GJINEKOLOGJI

D I S E R T A C I O N
I P A R A Q I T U R N G A :
Znj. MIGENA PRIFTI

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

“D O K T O R”

SPECIALITETI: OBSTETRIK – GJINEKOLOGJI

**TEMA: “MENAXHIMI I NDERLIKIMEVE FETALE SIPAS
TREMESTRAVE TE SHTATZANISE NE SHTATZANINE DIABETIKE
PRE DHE POST DIAGNOSTIKIT TE SAJ .INCIDENCA E TYRE NE
RRETHIN E DURRESIT”**

MBROHET NË DATË: /..... / 2016. PARA JURISË:

- KRYETAR
- ANËTAR (OPONENT)
- ANËTAR (OPONENT)
- ANËTAR
- ANËTAR

FALENDERIME:

Është vështirë të arrish deri këtu, pas shumë vite punë të shfletuara, të lexuara që përmbliidhen në këtë çast të vetëm: doktoraturën.

Falenderimi shkon për të gjithë ata që më ndihmuan, që më përkrahën, që më kuptuan si dhe me fjalën e tyre m'a bënë më te lehtë rrugën, që mes lodhjes sime më dhanë buzëqeshjen, që mes mërzitjes sime më zgjatën shpresën.

Tek fletet e kësaj pjesë punë të gjithë ju do t'a gjeni emrin: Profesor Gjergj Theodhosi, Doktor i Shkencave Mjekësore Brizida Refatllari, proff.ass. Arben Haxhihyseni, kolegët e mi në spitalin e Durrësit Dr.Kozeta Çani e Dr.Hysen Shkreli, që më besuan në trajtimin e rasteve të tyre, Gabriela Kraja që punoi edhe pa më njohur fare për të seleksionuar rastet e përfshira në studim.

Dhe midis reshtave bosh, në ato pak çaste pushimi gjendet mbështëtja e familjes sime, e prindërve të mi, mirekuptimi i bashkëshortit dhe i fëmijeve të mi te vegjël. Ju kam pjesën më të shtrenjtë ndaj pranoni mirenjohjen time.

Shpresoj që mundimi jonë i përbashkët t'ja arrijë qëllimit.

Ju faleminderit

Migena PRIFTI

PËRMBAJTJA

Parathënie - Konsiderata te përgjithshme.....	8
1. Fakte të njohurat mbi diabetin gestacional dhe ndikimin e tij tek fetusin.....	10
1.1 Pak histori.....	10
1.2 Epidemiologjia dhe faktorët e riskut për diabetin gestacional.....	14
1.3 Fisiopatologjia e diabetit gestacional.....	15
1.3.1 Metabolizmi nënë-fetus gjatë një shtatzënie normale dhe devijimet në shtatzënië diabetike.....	15
1.4 Diagnostikimi i diabetit gestacional.....	19
1.4.1 Anamneza obstetrikale.....	20
1.4.2 Ekzaminimet laboratorike.....	21
1.5 Prediabeti.....	22
1.5.1 Provat me glukozë orale.....	24
1.5.2 Ekografia.....	26
1.5.3 Monitorim fetal.....	29
1.6 Pasojat e diabetit gestacional në jetën fetale intrauterine.....	30
1.6.1 Ndarja e anomalive sipas tremestrave.....	31
2. Te dhëna rreth studimit të ndërmarrë.....	39
2.1 Objektivi i përgjithshëm.....	39
2.2 Qëllimi i studimit.....	39
2.3 Hipoteza e këtij studimi.....	39
2.4 Metodologjia dhe baza e studimit.....	40
2.4.1 Periudha kohore e studimit.....	40
2.4.2 Vendi i studimit.....	40
2.4.3 Variablat socio-demografike.....	40
2.4.4 Aprovimi etik.....	41
2.4.5 Miratimi i informuar.....	41
2.4.6 Popullata në studim.....	41
2.4.7 Kriteret e përzgjedhjes dhe të përjashtimit.....	41
2.4.8 Ekzaminimet bazë të përzgjedhjes.....	42

2.4.9 Metoda e marrjes së glukozës.....	42
2.4.10 Ekzaminimet rutin.....	43
2.4.11 Tipi i studimit.....	43
2.4.12 Analiza statistikore.....	43
2.4.13 Hapat e studimit.....	44
2.4.14 Grupimi i të dhënave studimore.....	47
2.4.15 Të dhëna të përgjithshme për subjektet në studim.....	47
3. Rezultatët e studimit.....	49
3.1 Tabelat përshkruese për tremestrin e parë: Pasojat intrauterine tek embrioni deri në javën e 14-të të shtatzënisë.....	49
3.2 Tabelat përshkruese për tremestrin e dytë.....	53
3.3 Tabelat përshkruese për tremestrin e tretë.....	58
3.3.1 Tabelat përshkruese mbi ndikimi e anamnezës familjare.....	61
3.3.2 Tabelat përshkruese mbi ndikimi i paritetit në zhvillimin e diabet gestacional.....	61
3.3.3 Tabelat përshkruese mbi ndikimi i peshës së gruas në shfaqjen e diabet gestacional.....	61
3.3.4 Tabelat përshkruese mbi ndikimi i paritetit tek komplikacionet fetale.....	63
3.3.5 Tabelat përshkruese mbi ndikimi i moshës së gruas tek komplikacionet.....	64
3.3.6 Tabelat përshkruese për lindjen.....	66
3.4.1 Tabelat përshkruese mbi ndikimi e ndryshimeve të glicemisë tek pesha.....	66
3.4.2 Tabelat përshkruese mbi ndikimi e ndryshimeve të glicemisë në mënyrën e lindjes.....	68
4. Diskutimi.....	70
4.1. Anamneza personale e familjare për diabet (të afërmit deri në brezin e parë).....	71
4.2 Indeksi i masës trupore (ITM) – mbipesha.....	72
4.3 Moshë e gruas.....	73
4.4 Pariteti.....	74
4.5 Raca dhe etnia.....	75
4.6 Kontrolli i shëndetit amtar dhe fetal gjatë diabet gestacional.....	75
5. Konkluzione dhe rekomandime.....	79
6. Bibliografia.....	81
Shtojca 1 - Situata në vendet mesdhetare për diabetin gestacional sipas FIGO 2015.....	94

Shtojca 2 - Guidelinë numër tre i Intitutit Kombëtar te Shëndetit dhe Kujdesit Shëndetesor në Mbretërinë e Bashkuar (NICE).....	95
Shtojca 3 - Propozimet e Bordit European për Obstertikën dhe Gjinekologjinë mbi depistimet për diabetin gestacional dhe menaxhimin e obezitetit.....	97

Lista e figurave

Figura 1. Libri i Prischilla White “Diabeti në fëmijëri dhe adoleshencë”.....	12
Figura 2. Klasifikimi i faktorëve kryesore të riskut për diabetin gestacional.....	15
Figura 3. Paraqitja e të dhënave mbi vlerat e adiponectinave në shtatzanënite diabetike.....	18
Figura 4. Algoritmi që ndiqet gjatë shtatzënisë në rast se suspektohet diabet gestacional.....	21
Figura 5. Çrregullimet e glicemisë t= kategori sipas etiologjisë dhe stadeve te patologjisë.....	22
Figura 6. Paraqitet xhepi i pasëm tek një gravidancë 28-29 javëshe, i cili i kalon 6cm pa pjesë të vogla në të.....	27
Figura7.Paraqitja e mungesës së likidit amniotik në fetusin 20 javësh,.....	28
Figura 8.Figura 8. Ndryshimet placentare kalcifike të linjës bazale (majtas) dhe të gjithë placentës (djathtas).....	29
Figura 9. Vendi që zenë pasojat fetale te shtatzënisë diabetike gjatë tremestrit te parë.....	50
Figura 10. Paraqitja e shpërndarjes sipas grupmoshave të rasteve në studim.....	51
Figura 11. Paraqitja e shpërndarjes së rasteve me diabet gestacional të ndara sipas diagnozave.....	52
Figura 12. Paraqitet shpërndarja sipas paritetit e rasteve me prediabet.....	53
Figura 13. Shpërndarja e anomalive sipas sistemeve jetesore të prekura.....	55
Figura 14. Shpërndarja e rasteve me prediabet dhe diabet te kategorizuar sipas moshës.....	55
Figura 15. Shpërndarja e anomalive sipas moshës.....	56
Figura 16. Shpërndarja e patologjive sipas tremestrit te tretë.....	60
Figura 17. Paraqitja e rasteve me obezitet në krahasim me peshën normale në tre kategorizimet.....	63
Figura 18. Paraqitja e t= dhënave krahasuese në tremestrit e tretë.....	66
Figura 19. Përqindja e makrosomisë prediabetike në makrosominë totale brenda grupit të kontrollit.....	67
Figura 20. Përqindja e lindjeve me s/cezarea në grupin e kontrollit.....	69

Lista e tabelave

Tabela 1. Kriteret e vendosura në vitin 2014.....	24
Tabela 2. Përmbledhje studimesh në viti 2014.....	25
Tabela 3. T= dhënat në përqindje të anomalive në DG sipas autoreve të ndryshëm.....	31
Tabela 4. Incidenca e abortit spontan në shtazënitë me diabetin gestacional.....	32
Tabela 5. Tabeta paraqet anomalitë kongenitale sipas Pedersen.....	34
Tabela 6. Paraqet studime për anomalite sipas organëve dhe/ose sistemeve që prek DG.....	35
Tabela 7. Paraqitja e moderuar e përfundimeve nga testi i ngarkesës me glukoz= (GCT) sipas kriterëve 2014.....	42
Tabela 8. Ndarjen sipas grupmohave t= pasojave fetale t= tremestrit të parë të lidhuara me ndryshimet e glicemisë.....	46
Tabela 9. Paraqet krahasimin midis paritetit të pacienteve dhe nivelit të glicemisë (tremestri I).....	50
Tabela 10. Paraqet shpërndarjen sipas diagnozave për paciente me glicemi esëll mbi 95 mg/dL.....	51
Tabela 11. Paraqet krahasimin midis anomalive fetale dhe moshës së gruas në kategori.....	52
Tabela 12. Paraqet krahasimin midis anomalive fetale dhe paritetit të pacienteve.....	54
Tabela 13. Paraqet krahasimin midis anomalive fetale dhe nivelit të glicemisë për tremujorin II.....	56
Tabela 14. Paraqet krahasimin midis peshës së gruas dhe nivelit të glicemisë për tremujorin II.....	57
Tabela 15. Paraqitet shpërndarja e rasteve të kategorizuara sipas patologjive kryesore.....	58
Tabela 16. Paraqet krahasimin midis nivelit të glicemisë për tremujorin III dhe anamnezës për diabet.....	60
Tabela 17. Paraqet krahasimin midis paritetin dhe nivelit te glicemisë për tremujorin III.....	61
Tabela 18. Paraqet krahasimin midis nivelit të glicemisë për tremujorin III dhe peshës së gruas.....	61
Tabela 19. Paraqet krahasimin midis paritetin dhe komplikacionëve për tremujorin III.....	62
Tabela 20. Paraqet krahasimin midis moshës së pacienteve (në kategori) dhe komplikacionëve për tremujorin e tretë.....	64
Tabela 21. Paraqitja e të dhënat mbi frekuencën e diabetit gestacional tek çdo patologji barrë.....	64
Tabela 22. Paraqet krahasimin midis nivelit të glicemisë për tremujorin III dhe peshës së fetusit.....	65
Tabela 23. Paraqet krahasimin p=r nivelit të glicemisë për tremujorin e III dhe mënyrës së lindjes.....	67
Foto 1: Fëmijë me peshë lindje 4950 gram nga nënë me prediabet 97mg/dl dhe HbcA1 6.1.....	68

PARATHËNIE

Diabeti njihet gjerësisht si një nozologji endokrinë i cili shoqërohet me çrregullime të nivelit të glukozës në gjak, rritje të nivelit të saj dhe si rezultat përdorimin e insulinës apo preparatëve medikale që sjellin uljen edhe stabilizimin e këtyre vlerave. Prej fillimit diabeti është kategorizuar në dy lloje: insulinovartës dhe jo insulinovartës. Por prej vitit 1979, për arsye të rritjes së incidencës së shfaqjes si dhe rëndësisë së saj u fut si kategori më vete diabeti gestacional, apo diabeti i shfaqur për herë të parë gjatë shtatzënisë dhe që mund të zhduket ose dhe të përsistojë pas lindjes. Ajo u përcaktua si intolerance e dëmtuar e glukozës që shfaqet në këtë periudhë të jetës së gruas. Gjatë studimit të saj me kalimin e kohës u veçua prediabeti, me vlera të ndërmjetme të glicemisë, si gjendje prediabetike tek një grua shtatzënë.

Diabeti gestacional është studiuar nga shumë autore, duke filluar nga P.WHITE, e cila bëri dhe klasifikimin e parë të kësaj nozologjie dhe vendosi edhe hapat e parë në menaxhimin e saj, dhe deri në shoqatat e ndryshme ndërkombëtare të diabetit në shtatzëni, të cilat kanë ndërmarrë studimin masiv në popullatë mbi shtrirjen e gjerë të kësaj patologjie dhe efektet në shëndetin amtaro-fetal. Janë këto studime dhe të dhëna që duke i marrë parasysh vlen të theksohet për rëndësinë e kësaj patologjie në kuadrin e terësisë së problemeve që hasim gjatë shtatzënisë, mbase dhe përpara fillimit të saj.

Në vendin tonë, pavarësisht hasjes së shpeshtë të pasojave të diabetit gestacional, nuk është ndërmarrë deri tani një studim i hollësishëm për të përcaktuar incidencën kombëtare të tij, shfaqjen e problematikave lidhur me të, menaxhimin jo hospitalor dhe spitalor të këtyre problemeve dhe qëndrave të specifikuara lidhur me te. Duke qenë se në hyjmë në rajonin mesdhetar incidenca vetëm nga ky faktor rritet, nga 3 deri në 5 përqind që është ai botëror, në 8 përqind të patologjive të shtatzënisë. Nëse do të merrnim parasysh këtu ndryshimet e vendit tonë brenda 20 vjeçarit të fundit në lidhje me mënyrën e jetesës dhe atë të ushqimit kjo shifër do të vazhdojë të rritet. Ndërkohë që nga ana tjetër njohuritë mbi këtë patologji dhe rëndësinë që ka ajo gjatë shtatzënisë pak e njohin në popullatë.

Pikerisht kjo shërbeu si shtysë fillestare në fillimin e kësaj punë. Studimi u shtri në popullatën e grave shtatzëna, të paraqitura pranë ambienteve të spitalit të Durrësit gjatë një periudhë kohë të konsiderueshme. Për të bërë me konkret ndikimin e diabetit gestacional, jo vetëm tek nëna por dhe tek fëmija, studimi u realizuar i ndarë në tremenstrat kohore të zhvillimit të fetusit. Pra, grupi i grave të paraqitura u shpërbë në nëngrupe sipas moshës së barrës dhe problematikës së shfaqur. Të dhënat u mblodhën dhe u përpunuan statistikisht sipas programeve statistikore SPSS V.17 (version 17.0, Chicago, IL) dhe Excel për paraqitjen vizuale.

Përfundimet e nxjerra nga ky studim janë mjaft domethënëse, jo vetëm mbi atë që është bërë por dhe mbi çka duhet te bëhet për te pasur sa më pak ndërlikime te kësaj patologjie për shëndetin amëtar dhe fetal, kjo e bazuar dhe e ballafaquar dhe me studimet dhe përfundimet e literaturave bashkëkohore ndërkombetare. Gjithashtu të dhënat, mënyrat dhe konkluzionet e këtij studimi të shpresojmë që të shërbejnë si pikënisje për studime të tjera në ndihmë të problematike të shëndetit amëtaro-fetal.

KAPITULLI I

FAKTE TE NJOHURAT MBI DIABETIN GESTACIONAL DHE NDIKIMIN E TIJ TEK FETUSI

1.1 Pak histori

Diabeti gestacional është përcaktuar si intoleranca ndaj glukozës ose prania e niveleve të larta të glicemisë në gjak **gjatë shtatzënisë**, që zakonisht zhduket pas lindjes ^[1, 2,3,4,5]. është diskutuar për prishje të ekuilibrave metabolikë në organizëm gjatë shtatzënisë dhe kjo kryesisht në nivelin e karbohidratëve ^[6,7]. Karakterizohet nga rritja e rezistencës ndaj insulinës dhe çrregullimet në sekretimin e saj^[8]. Gjithashtu, në diabetin gestacional, absorbimi i glikozës ulet dukshëm. Kështu hiperglicemia e shtatzënisë nuk rezulton të këtë lidhje me përthithjen shumë të shpejtë apo te rritur te glukozës.

Referimi i parë për diabetin në shtatzëni është bërë nga **Bennewitz në vitin 1823**. Ai e konsideronte diabetin si një simptomë transitorë të shtatzënisë dhe e vërtetonte këtë me dy raste studimi, ku glucosuria dhe gjithë simptomat e tjera zhdukeshin pas përfundimit të shtatzënisë ^[9].

Prischilla White (1900-1989) që ajo që studioi dhe paraqiti rezultatët e para mbi këtë patologji në fillim të shekullit të 20-të. Duke vënë re se, gratë që vuanin nga diabeti kishin shtatzëni të vështirë dhe mundësi të pakta për të finalizuar me sukses shtatzëninë e tyre, ajo realizoi studimin e saj me besimin se gratë diabetike nuk e kanë të kundërindikuar shtatzëninë ^[10,11].

Në 1928 ajo do të shkruante: *“Diabeti i kontrolluar është thelbësor për mirëqenien e fetusit. Aksidentet diabetike, koma dhe hipoglycemia, janë të parandalueshme. Prandaj, numri i vdekjeve fetale nga aksidentet diabetike tani duhet të jetë më të pakta. Doza të vogla të insulinës të dhëna shpesh, nëse është e nevojshme, janë më të preferueshme se doza të mëdha të dhëna në intervale të largëta dhe hipoglycemia në këtë mënyrë mund të shmanget mbikëqyrja e ngushtë dhe e vazhdueshme e pacientit nga të dy mjeket obstetër-endokrinolog, është pjesa më e rëndësishme e trajtimit. Në këtë mënyrë shumë nga aksidentet e shtatzënieve diabetike mund të shmangen dhe një numër në rritje i nënave diabetike do të lindin foshnja të gjalla.”*

Në vitin 1932 do të botonte literaturën e parë të plotë: “Diabeti në fëmijëri dhe adoleshencë”. Ndërsa në vitin 1949 ajo publikoi versionin e parë të klasifikimit të diabetit në bazë të komplikacionëve të tij. Në 1979 ky klasifikim i është nënshtruar revizionimit të fundit që edhe njohim^[12].



Figura 1. libri i Prischilla White “Diabeti në fëmijëri dhe adoleshencë”

Klasifikimi WHITE ^[13]

Klasa A1 : diabet gestational; dietë e kontrolluar

Klasa A2: diabet gestational; mjekim i kontrolluar

Grupi i dytë i diabetit , i cili mund të ketë ekzistuar edhe para shtatzënisë ndahet në këto klasa:

Klasa B: fillimin të moshës 20 (ose më i vjeter) dhe me kohëzgjatje prej më pak se 10 vjetesh

Klasa C: Fillimin në moshën 10-19 vjecare apo kohëzgjatje prej 10 deri në 19 vjet

Klasa D: Fillimin para moshës 10 vjecare dhe /ose kohëzgjatje më të madhe se 20 vjet

Klasa E: Diabeti mellitus me ndryshime të vazave të gjakut të baçinit

Klasa F: Nefropati diabetike

Klasa R: Retinopatia proliferative

Klasa RF: Retinopatia dhe nefropatia

Klasa H: sëmundjet ishemike të zemrës

Klasa T: i nëvojshëm transplantit renal

Jorgan Pedersen (1914-1978) prezantoi në vitin 1952 hipotezën hiperglicemi amtare – hiperinsulinëmi fetale ^[14]. Kjo teori u pranua pas 20 vitesh dhe tani quhet teoria Pedersen. Në 1967 ishte probabilitet i pari që përdori termin **diabeti gestacional**.

Studimi i parë i rëndësishëm është botuar në Boston në 1954 me provën e dhënies së 50 mg glukozë, i paraqitur nga **O'Sullivan dhe Mahan** ^[15]. Në një paraqitje të mëvonshme të plotësuar të studimit u treguan se vlerat e larta të glicemisë janë paralajmëruese për një diabet të ardhshëm. Këto studime vazhduan përgjatë viteve 60 – 70 duke u bazuar në ndikimin e diabetit tek shëndeti i nënës dhe fëmijës duke dhënë korrelacionet e para midis kontrollit të varfër glucidik në këto shtatzëni dhe rritjes së mortalitetit perinatal ^[16].

Diabeti gestacional u njoh si nozologji klinike në muajin Tetor të vitit 1979, në shtetin e Cikagos, U.S.A. në konferencën e parë internacionale për diabetin gestacional. Në këtë takim punë grupi kombëtar i të dhënave mbi diabetin (National Diabetes Data Group) dha një klasifikim të përditesuar mbi llojet e diabetit, duke e dhënë të veçuar diabetin në shtatzëni. Ajo u deklarua si patologji me rëndësi të veçantë për shëndetin e nënës dhe që kërkon vëmendje dhe trajtim të veçantë. Vendosja e këtij termi u bë për të marrë më seriozisht këtë patologji jo vetëm nga gratë, por edhe nga sigurimet shëndetsore për të ofruar trajtim falas. Në shumë literatura gjendet me shkurtime si GD apo GDM.

Pikërisht në këtë konferencë mori formë dhe përkufizimi përfundimtar mbi diabetin gestacional si: **"intolerancë e karbohidratëve në shkallë të ndryshme graviteti, që shfaqet apo njihet për herë të parë gjatë shtatzënisë"** ^[17].

Përkufizimi gjen përdorim edhe nëse insulina është përdorur për trajtimin apo kjo gjendje vazhdon edhe pas shtatzënisë, por nuk e përjashton mundësinë që kjo të ketë qenë kalimtare me shtatzëninë.

Në vitin 1989 OBSH-ja dhe Organizata e Pacientit nga të gjitha vendet europianë mblodhen në St.Vincent, Itali, specialiste nga të gjitha vendet për patologjinë e diabetit. Nën përkujdesjen e WHO (World Health Organization) dhe të Federatës Ndërkombëtare të Diabetit u përcaktuan rrugët dhe metodat për prevenimin, trajtimin dhe mjekimin e diabetit. Deklarata e Saint Vincent i dha një rëndësi të madhe diabetit si patologji dhe domosdoshmërisë për t'a studiuar atë në nivel lokal dhe kombëtar për çdo vend. Pjesë e kësaj deklarate ishte dhe diabeti gestacional ^[18,19].

1.2 Epidemiologjia dhe faktorët e riskut tek diabeti gestacional

Diabeti gestacional me përhapjen e vet të komplikacioneve kap rreth 3-14% të shtatzënive ^[20] dhe janë shkak me i shpeshtë i problemeve neonatale, të cilat mund të shkojnë deri në përfundim fatal. Nga gjithë llojet e diabeteve që shfaqen në shtatzëni, diabeti gestacional kap 90-95 % të tyre ^[21,22,23]. Megjithatë studime të ndryshme japin vlera të ndryshme dhe kjo për faktin se varet nga lloji i studimit të kryer, pra nëse kemi të bëjmë me një studim prospektiv, retrospektiv apo analiza të dhënash nga anamneza. Gjithashtu varet nga vendi ku kryhet studimi, pasi rol kryesor në faktorët e riskut janë raca dhe etnia. Nga rezultatet e deklaruara nga WHO është vënë re se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës që kanë një shtrirje të gjerë gjeografike incidenca varion rreth 20%, kurse në Pima/Papango dhe në Indi vlerat janë 14-22 përqind ^[24].

Studimet e kryera nga ASA, shoqata për diabet gestacional në Sh.B.A, kanë treguar një rritje e prevalencës së diabetit mellitus: 21 milion njëerëz (shtatë përqind e popullsisë) kanë një formë të diabetit të diagnostikuar si dhe 6 milion njëerëz mund të diagnostikohen; veçanërisht me diabet të tipit dy tek gratë e moshës riprodhuese (në Shtetet e Bashkuara). Kjo ka rezultuar në rritjen e numrit të grave shtatzëna me diabet preekzistues.

Aktualisht, tipi dy i diabetit mellitus përbën tetë përqind të rasteve të diabetit mellitus në shtatzëni, dhe diabeti mellitus preekzistues tani prek një përqind të të gjitha shtatzënive. Gjithashtu, është vënë re se diabeti gestacional përseritet në shtatzënite pasardhëse nga 33 deri në 70 përqind të rasteve dhe kjo e lidhur ngushtë me faktorët e riskut si dhe me distancën midis shtatzënive (< 24 muaj) ^[25].

Një studim i Stuebe et al ^[26] ka gjetur se diabeti mellitus gestacional dhe toleranca e dëmtuar e glukozës gjatë shtatzënisë janë të lidhura me mosfunksionimin metabolik deri në 3 vjet pas lindjes (këtu

ndërhyjnë dhe faktorë të tjerë risku klinik). O’Raily et al ^[27] në përshkrimin e zgjeruar të zbulimit dhe diagnostikimit të diabetit gestacional arriti në përfundimin se disa faktorë ndikonin në mënyrë më të drejpërdrejte në ndryshimet e metabollizmit glucidik se pjesa tjetër ^[28]. Këto ishin :

1. Përdorimi i insulinës në shtatzëni
2. Anamneza familjare e diabetit tip 2 mellitus
3. Indeks i masës trupore mbi 30 para shtatzënisë (IMT)

kanë qenë faktorët që lidhen me disgluceminë e vazhdueshme në gratë që kanë pasur diabet gestacional.

Përveç kësaj, ndërhyrjet mjekësore gjatë shtatzënisë mund të rrisin mundësinë e zhvillimit të diabetit gestacional. Një studim i raportuar në vitin 2007 demonstroi një rritje të shkallës së diabetit gestacional tek femrat që përdorin kontraceptive orale të tipit 17 caproat alfa - hydroxyprogesteron për mjekimin e SOP ^[28]

- Moshë e gruas mbi 35 vjeç
- BMI
- Multipariteti
- Raca, etnia
- Anamneza personale e familjare për diabet (të afërmit deri në brezin e parë)
- Anamneza obstetrikale (shfaqja e diabetit gestacional ose ndërlikimeve të tij gjatë shtatzënisë paraardhëse)
- Sindromi i ovarit polikistik
- Shtatzënia multiple

Figura 2. Klasifikimi i faktorëve kryesorë të riskut për diabetin gestacional ^[30,31]

Prevalenca e diabetit gestacional është e lidhur ngushtë me racën dhe ndikimin kulturor të pacientit. Prevalenca është më e lartë në gratë me ngjyrë, hispanike, aziatike se në femrat e racës kaukazianë. Për shembull, në mënyrë tipike vetëm 1,5 deri në 2 përqind e grave të racës kaukazian kanë zhvilluar diabetin gestacional, ndërsa tek amerikanët-jugorët (në një studim në Shtetet e Bashkuara) vlerat arrijnë deri në 15 përqind ^[32]. Në popullsinë hispanike dhe aziatike incidenca varion nga 5 deri në 8 përqind ^[33].

Në këto popullsi me një rrezik të lartë, përsëritja e diabetin gestacional në shtatzënite e ardhshme është raportuar të jetë i lartë deri në 68 përqind te rasteve. Përveç kësaj, për afërsisht një e treta do të zhvillojë dukshëm diabetin mellitus brenda pesë viteve të ardhshëm, ndërsa tek grupet me risk të lartë shkon dhe afër 50 përqind [34,35,36]

Raca ndikon shumë edhe në ndërlikimet e diabetin gestacional. Për shembull, gratë me afro-amerikane kanë treguar të kenë norma më të ulëta të makrosomisë, pavarësisht nivleve të ngjashme të kontrollit glicemik [37].

Gjatë studimit Moisiu et al [38] është vlerësuar prevalenca e gestational diabet mellitus(GDM) në pacientet me faktorë të ndryshëm të rrezikut dhe janë rekomanduar testimet universale. Diabeti gestacional u diagnostikua në 6.7 përqind të grave në përgjithësi, në 8.5 % të femrave mbi 30 vjeç, në 12.3 përqind të femrave me një indeks të masës trupore 30 kg/m^2 ose më të madhe, dhe në 11.6 përqind të femrave me një histori familjare të diabetit (në një të afërm të breznisë së parë). Një kombinim i një apo të gjitha prej këtyre faktorëve të rrezikut parashikon shfaqjen e diabetit gestacional në 61% të rasteve me anamnezë të ngarkuar. Diabeti gestacional është i pranishëm në 4.8 % të grave pa faktorët e rrezikut.

Faktorët e riskut japin një ndihmëse shumë të madhe në diagnostikimin e hershem të diabetit gestacional. Studiues të ndryshëm [39] bëjnë një nënndarje të femrave në varësi të këtyre faktoreve në tre grupe:

1. Raste me risk të ulët: jodiabetike në anamnezë, <25 vjeç, ITM në parametra normale, pa femijë të lindur mbi 4000 gram
2. Raste me risk mesatar për ato që përjashtohet nga dy nëngrupet e tjera
3. Raste me risk të lartë; gratë me të gjithë faktorët e riskut dhe glukozuri

1.3 Fispatologjia e diabetit gestacional

1.3.1 Metabolizmi nënë-fetus gjatë një shtatzënie normale dhe devijimet në shtatzëninë diabetike

Tek gruaja shtatzënë, çdo ushqim apo vakt ushqyerje vë në lëvizje një seri komplekse veprimesh hormonale, duke përfshirë këtu edhe një rritje të glukozës në gjak dhe të sekretimit të insulinës sekondare pankreatike, glukagonit, somatomedinës dhe katecholaminës renale. Këto ndryshime arrijnë të sigurojnë një furnizim të mjaftueshëm, por jo të tepruar të glukozës që është në dispozicion nga nëna

për fetusin. Vetë shtatzënia normale është e prirur për një rritje progresive të insulino-rezistencës përgjatë tremestrave. Ndryshimi i insulino-rezistences vjen si rezultat i ndryshimit të lipolizës matërnë dhe efektit tek insulina e produkteve hormonale të placentës. Krahasuar me subjektet joshtatzënë, gratë shtatzëna kanë tendencë për të zhvilluar hipoglicemi (niveli i glukozës plazmatike bie në 65-75 mg/dL) në mes të ushqimit dhe gjatë gjumit. Kjo ndodh për shkak se fetusin vazhdon të terheqë glukozën nëpërmjet placentës nga qarkullimi i gjakut amtar, madje edhe jashtë periudhave të ushqyerjes.

Hypoglicemia midis vakteve bëhet gjithnjë dhe më e pranishme gjatë shtatzënisë duke qenë se nevojat fetale për glukozë rriten ^[40,41]. Nivelet placentare të steroideve dhe hormoneve peptide (p.sh. estrogjeni, progesteroni, dhe somatotropina korionike) rriten në mënyrë lineare përgjatë tremujorëve të dytë dhe të tretë. Për shkak se rritja e këtyre hormonëve jep rritjen e rezistencës periferike të insulinës (në inde), kërkesa për rritjen e sekretimit të insulinës gjatë ushqimit përshkallëzohet në mënyrë progresive gjatë shtatzënisë ^[42]. Në tremujorin e tretë, nivelet e insulinës mesatarisht në 24 – orë, janë 50 % më të larta se në pacientet joshtatzëna ^[43]. Me gjithë rritjen e sekretimit të insulinës pankreatike nga ana e nënës, ajo është e pamjaftueshme dhe sjell hiperglicemi tek fetusin. Kjo vihet re më tepër pas ushqimit, sidomos një darkë të pasur me kalori, në të cilën nevojat fetale rriten dhe për pasojë ky është dhe burimi kryesor i përshpejtimit të rritjes fetale (makrosomia).

Sipas Dodd, ndryshimet e nivelit të glicemisë feto-amtare janë të lidhura ngushtë me nivelin e hiperinsulinemisë fetale. Kjo e fundit shkon paralel me rritjen e depozitimit të burimit të energjisë apo kalorive nga ana fetale, pra fillimet e majkrosomisë ^[45, 46, 47]. Mekanizmat që shpjegojnë rritjen e nevojave për insulinë janë të shumta por dy kryesoret janë:

1. Katabolizmi i rritur i insulinës në nivelin placentar
2. Insulino-rezistenca e lidhur pjesërisht me sintezën e rritur të hormonit placentar, për arsye të shkatërrimit prej kësaj të fundit të receptorëve të insulinës (IRS-1) ^[41,47]

Nga ana tjetër shpenzimet e enërgjisë nga ana e fetusit për të konvertuar glukozën e tepërt në trigliceride con në uljen e sasisë së oksigjenit fetal. Kjo hipoksi fetale është e lidhur me:

1-katëkolaminën renale, e cila do të cojë në hipertension, rimodelim kardial e më pas hipertrofi kardiake,

2-eritropoetinën, e cila jep hiperplazi të eritrociteve dhe rritje të hematokritit

Prania e hormonit placentar bën uljen e tolerancës ndaj glukozës, që con në rritjen e insulinemisë, sidomos në pacientet e riskuar për diabet gestacional [48]. Po ashtu, estrogeni dhe progesteroni shkaton rritje të lehtë të insulinemisë tek personat e predispozuar për diabet. Metabolizmi i nënës ndryshon nën ndryshimin e vlerave të glicemisë, duke sjellë ndryshimin e funksionit të disa organeve [49,50]. Këto pasoja janë të njohura si komplikacione të diabetit mellitus, por më të rëndësishmet të lidhura me diabetin gestacional janë nefropatia dhe hipertensioni arterial, të cilat komplikojnë të dy palët.

Studimet e fundit kanë treguar faktorë të tjerë, që korrelojnë vlerat e tyre në diabetin gestacional, sic janë faktori i nekrozës tumorale TNF-ja, adrenomedulina dhe adiponectina [51,52,53]. E para dhe e treta i përkasin familjes së adipocitokinave që përfshijnë leptinën, rezistinën, interleukinën 6 etj. Adiponectina është e shoqëruar me obezitet, diabet, çrregullime kardiovaskulare dhe dislipidemitë [54,55].

Te dhëna nga studimet mbi vlerat e tyre në grupe studimi të shtatzënive diabetike paraqiten në mënyrë të përpunuar [57, 56] figurën e mëposhtme:




Figura 3. Paraqitja e te dhënave mbi vlerat e adiponectines në shtatzënite diabetike

Përqindja më e madhe e diabetin gestacional është diabet mellitus i tipit dy, por duke pasur parasysh se në këtë studim, gratë e marra për kontroll nuk janë diagnostikuar për diabet ekzistues apo të

mjekuar, janë përjashtuar nga të dhënat statistikore problemet ekzistuese të diabetit dhe është përqendruar vëmendja tek problemet që jep diabeti në shtatzëni tek gruaja e më pas tek fëmija.

Vendin e parë në këto ndryshime e zenë ato renale ^[58]. Normalisht gjatë një shtatzënie normale filtri glomerular rritet me 30-50%, si rezultat rritet dhe proteinuria. Korrelacionet në ecurinë e një shtatzënie diabetike dhe patologjive renale sipas studimeve të ndryshme nuk kanë përputhje, që do të thotë nuk është e pritshme me patjetër një preeklampsi tek një diabet gestacional, por progresioni i patologjive renale tek një shtatzënë diabetike është i lidhur me kohëzgjatjen e diabetit dhe kontrollin e glicemisë të pacientes ^[60,59]. Komplikacionet më të hasura për fetusin tek një shtatzënë diabetike me probleme renale janë:

- Lindja preterm me të gjitha problemet e prematuritetit tek fetusit^[61]
- Hipertensioni arterial deri në preeklampsi^[62]
- Hipotrofia fetale deri në feto morto in utero.

Makrosomia ngelet një nga komplikacionët më të përmendura të diabetit gestacional. është vërtetuar se rreth 30% e lindjeve nga gra që kalojnë diabetin në shtatzani lindin fëmijë me peshë të madhe ^[63], mbi 4000 gram. Kjo gjë vështirëson lindjen, gjendjen e bebit dhe te gruas post partum. është një nga arsyet e përfundimit të lindjes me sectio/cezarea për arsye të disproporcionit fetopelvik.

Në makrosominë e shkaktuar nga diabeti, rolin kryesor e luan placenta dhe shkëmbimi i ushqimit që kryhet nëpërmjet saj në muajt e fundit. Duke u bazuar dhe në teorinë e mësipërme për ndikimin e disa faktorëve hormone të prodhuar nga placenta nën ndikimin e vlerave të larta të glicemisë amtare është vërejtur edema e stromës së vileve placentare duke çuar në “hiperprodhimin” e vazave të reja, të cilat rrisin sipërfaqen e kontaktit midis nënës dhe fetusit dhe kështu rritet dhe sasia e ushqimit që arrin tek fetusit^[64]. Është vërtetuar korrelacioni midis një peshë të madhe placentare (placentomegali) dhe peshës të madhe fetale (makrosomi), por ende nuk ka të dhëna nëse e para është shkak apo pasojë e të dytës ^[64,65].

1.4 Diagnostikimi i diabetit gestacional

Vendosja e diagnozës tek një grua shtatzënë për diabet gestacional është diskutuar mbi bazën e shumë kritereve në disa protokolle ^[66,67,68,69,70], por në të gjitha testi i ngarkesës me glukozë 50 mg është konsideruar “standarti i arte” e vendosjes së diagnozës GDM (Scott 2002 ^[71]). Diskutimi se cilat do të

jenë kriteret kryesore për vënien e diagnozës së saktë të GDM akoma vazhdon, sepse në varësi të kriterëve të vendosura është dhe rezultati mbi vendin që kap GDM në popullatë ^[72].

1.4.1 Anamneza obstetrikale

Rol kryesor në anamnezën obstetrikale zë pariteti ^[73] dhe moshja e femrës. Prej visites së parë këto janë të dhënat fillestare që i merren një gruaje shtatzënë. Nëse kemi të bëjmë me një primigravida, atëherë anamneza do të kanalizohet më tepër në atë familjare për të kërkuar te afërm që të kenë vuajtur me diabet. Kryesisht përqëndrohemi tek brezi i parë i të afërmeve: babai, nënës, moter, vëllai. Nëse pacientja jonë është pluripare, atëherë përqëndrohemi në fillim në anamnezën obstetrikale e më pas në atë familjare ^[74]. Në anamnezën obstetrikale do të kërkojmë për përfundimin e shtatzënive të tjera, nëse ato kanë pasur ecuri normale apo janë ndërprerë për arsye të ndryshme, cilat kanë qenë këto arsye: ekzaminimet e kryera gjatë shtatzënisë së kaluar nëse ajo ka qenë e shoqëruar me patologji të ndryshme. Nëse kanë përfunduar cila ka qenë pesha e fëmijës në lindje, rruga e lindjes dhe a ka pasur probleme fëmija i tyre pas lindjes.

Nëse kemi të bëjmë me një femër primigravida mbi 35 vjeç duhet të kërkojmë ekzaminimet rutinë për diabetin gestacional dhe t'a trajtojmë si një rast të rrezikuar për diabet edhe pa i pritur përgjigjet e tyre. Gjithashtu në këto raste duhet pyetur me kujdes gruaja për të zbuluar nëse kemi të bëjmë me rastin e një steriliteti primar, apo përdorimin e kontrceptiveve orale.

Në viziten e parë gjithashtu merren vlerat e para të peshës trupore dhe tensionit arterial. Këto do të shënohen në kartelën obstetrikale (të konsultorit) për t'i ndjekur në dinamikë gjatë shtatzënisë ^[75].




Figura 4. Algoritmi që ndiqet gjatë shtatzënisë në rast se suspektohet diabet gestacional

1.4.2 Ekzaminimet laboratorike

Ekzaminimi bazë i kësaj patologjie është matja e vlerës së glicemisë ^[76]. Lohatja e saj është e lidhur ngushtë me intolerancën ndaj glukozës në shtatzëni. Glicemia esëll (GE) është ekzaminimi rutinë laboratorik për këtë patologji. Vlerat normale të glicemisë esëll janë 70-110 gr/ml. Në një shtatzëni normale, duke patur parasysh tendencën për hipoglicemi të nënës, këto vlera rrallë e kalojnë 90 gr/ml. Por është vënë re se ka mjaft gra të cilat kanë rritje të vlerave të glicemisë esëll sipër këtij kufiri. Këto gra kanë të ashtuquajturin dëmtim të tolerancës së glukozës ose ndryshe njihet me termin **prediabet**. Këtu përfshihen gratë tek të cilat *glicemia esëll gjendet mbi vlerat 95 mg /dL, por është nën 110 mg/dl*. Faktikisht ky është dhe grupi me numrin më të madh të pacientëve sepse në këtë stad gruaja:

- Nuk ka shqetësime
- Mund të mos këtë obezitet apo trashëgimi për diabet
- Nuk ka anamnezë të ngarkuar obstetrikale





NIVELET Tipet	NORMOGLICEMIA	HIPERGLICEMIA		
	NORMAL GLUKOZ REGULATION	PRE- DIABET	DIABET MELLITUS	
			i-v	jo i-v te tjera
Tipi I				
Tipi II				
Tipe te ndryshme				
Diabeti gestacional GDM				

Figura 5. Çrregullimet e glicemisë sipas etiologjisë dhe stadeve të patologjisë [77]

1.5 Prediabeti

Prediabeti është një term i përdorur për të dalluar njëriqit që kanë një rrezik në rritje të zhvillimit të diabetit. Njëriqit me prediabet kanë tolerancë të dëmtuar e glukozës (IGT). Disa njëriq mund të kenë të dëmtuar edhe nivelin e glicemisë esëll, gjendje në të cilën niveli i sheqerit në gjak esëll është ngritur (100-125 mg/dl), por nuk është e lartë sa për t'u klasifikuar si diabeti. Toleranca e dëmtuar e glukozës është një gjendje në të cilën vlera e glicemisë është e lartë (140-199 mg/dL pas një OGTT dy orësh), por nuk është e mjaftueshme për t'u klasifikuar si diabet [78].

Shoqata Botërore e Endokrinologjisë jep udhëzimet e reja për GDM sipas të cilave [79,80]:

A) Të gjitha gratë shtatzëna, edhe ato të padiagnostikuara me diabet, duhet të kontrollohen për këtë patologji me një nivel te glicemisë esëll (GE), me nivelin e hemoglobinës së glukozuar (HbA1c), ose

me një glicemi të thjeshtë plazmatike prej vizites së parë të shtatzënisë, e cila kryhet brenda 10 javëshit të parë të gravidancës.

B) Një GE prej 126 mg/dL ose më e lartë (≥ 7.0 mmol/L), një glicemi e rastit nga 200 mg/dL ose më e lartë (≥ 11.1 mmol/L), ose një HbA1c prej 6.5 përqind e lart tregon diabet të qartë (tipi 1, ose e tipit 2), ndërsa një GE nga 92-125 mg/dL (5,1 deri në 6,9 mmol/L) tregon diabet gestacional apo prediabet. Një diagnozë e diabetit duhet të konfirmohet me një test të dytë (GE, glicemi e rastit, HbA1c, ose me provën e ngarkesës me glukozë orale, OGTT)

C) Gratë, që deri në javën e 24-të të shtatzënisë ende nuk janë diagnostikuar me diabet mellitus ose gestacional, duhet që në mes të javës së 24-të dhe 28-të të shtatzënisë, t' i nënshtrohen një testi me ngarkesë 75 gram glukozë orale, OGTT, për diabet gestacional. Kjo mat nivelet e glicemisë deri në 2 orë pas marrjes së ngarkesës. Në këtë moshë të shtatzënisë, një rezultat 153-199 mg /dL (8,5-11 mmol/L) 2-orë pas marrjes së 75 gram OGTT tregon diabet gestacional, ndërsa një rezultat e provës me 200 mg/dL ose më i lartë (≥ 11.1 mmol/L) tregon diabet të dukshëm.

Sipas Shoqatës Amerikanë të Diabetit "Standardet e kujdesit mjekësor në diabet, 2010" ^[81] prania e çdo një prej kritereve të mëposhtme mbështet diagnozën e diabetit gestacional:

- Hemoglobina e glukozuar (HbA1c) është 6.5 %
- Glukoza plazmatike esëll është $> 92-126$ mg/dL (7.0 mmol/L)
- Niveli i glukozës plazmatike është 200 mg/dL (11.1 mmol/L) gjatë një 75 - gram OGTT pas dy orësh
- Niveli i glukozës plazmatike të rastit >200 mg/dL (11.1 mmol/L) në një pacient me simptoma klasike të hiperglicemisë ose krizës hiperglicemike.

Në mungesë të hiperglicemisë së qarte, një diagnozë e bazuar në një prej tre kritereve të para duhet të konfirmohet nga testimi i përsëritur në një ditë tjetër.

Në vitet 2013 dhe 2014 studimet nga NIH dhe IADPSG rishikuan Kriteret për diagnostikimin e diabetin gestacional, në bazë të të dhënave laboratorike dhe në vitin 2014 organizata botërore e shëndetit (OBSH), vendosi se nëse të paktën dy të dhëna (1 ose më shumë) nga tabela e mëposhtme janë pozitive atëherë pacientja diagnostikohet me diabet gestacional ^[82,83].

Tabela 1. Kriteret e vendosura në vitin 2014 nga OBSH-ja

Ekzaminimet	Niveli i glicemisë
Glicemi esëll	92-125 mg/dl
Një orë	180 mg/dl
Dy orë	153 mg/dl

Me këto kritere pritet që incidenca e diabetit gestacional të kapë shifra rreth 18 përqind të patologjive të shtatzënisë.

1.5.1 Provat me glukozë orale

Janë prova që bëhen për vendosjen e diagnosës së diabetit gestacional në moshë shtatzënie 22 deri në 26 javë. Testi i parë mund të përdoret dhe brenda tremujorit të parë tek personat me gjasa të larta të zhvillimit të kësaj nozologjie.

- A)** 50 - gram, glicemia pas një ore kryhet testi i ngarkesës së glukozës (GCT).
- B)** 100 gram, tre ore kryhet testi i tolerancës me glukozë orale (OGTT) (Për pacientet me një rezultat jonormal të GCT)

Nga ana tjetër, për gratë me rrezik të lartë ose në zona ku prevalenca e rezistenca nga insulina është 5 përqind ose më të lartë (p.sh. Jug-Perëndimore dhe Jug-Lindore të Shteteve të Bashkuara), mund të përdoret duke ndjekur direkt me 100 - gram, 3 - orë OGTT

- C)** Marrja e 50 g glukozë orale ose e ashtuquajtura ndryshe testi i ngarkesës me glukozë (GCT), ka një vlerë të madhe. I përshkuar për herë të parë nga O’Sullivan në vitin 1950 ai vendosi një hap përpara në diagnostikimin e diabetit gestacional ^[84].

D) Testi i tolerancës me glukozë orale, që bazohej në marrjen e 100 gram ose 75 gram glukozë dhe vlerësimin e glicemisë një, dy, tre orë pas marrjes. Klasifikimi i vlerave është bërë nga NDDT dhe më pas nga Carpentier & Coustan nga të cilët mori edhe emrin ^[85,86].

Tabela 2. Përmbledhje studimesh ^[87] në viti 2014

Studimet	Ngarkesa (g)	Vlera mg/ml(mmol/l)				Pikëzimi në diabet gestacional
		Esëll	1 h	2 h	3 h	
IADPSG/ADA	75	92 (5.1)	180 (10.0)	153 (8.5)	-	≥ 1
WHO	75	92 (5.1)	180 (10.0)	153 (8.5)	-	≥ 1
ADIPS	75	- (5.1)	- (10.0)	- (8.5)	-	≥ 1
NIH/ACOG; ADA	100	95 (5.3)	180 (10.0)	155 (8.6)	140 (7.8)	≥ 2
CDA	75	- (5.3)	- (10.6)	- (9.0)	-	≥ 1
NICE	75	- (5.6)	-	- (7.8)	-	≥ 1

Kriteret për të kryer proven e ngarkësës me glukozë janë ^[88]

1. Dietë e pasur me karbohidratë dy ditet e fundit
2. Në mbremje mos të konsumojë pije të pasura me glukozë apo fruktozë
3. Të ndërpritet medikamentet që ndikojnë në nivelin e glicemisë
4. Të ndërpritet pirja e duhanit
5. Esëll, pas marrjes së kampionit të parë të gjakut për ekzaminim konsumimi i një pijë te embël, që te përmbajë 100 gram glukozë

Matje tjetër e rëndësishme në diabetin gestacional është hemoglobina e glukozuar e cila ka korrelacionë pozitiv të forta në rastet kur diabeti ka kohë i instaluar por është ende i pazbuluar. Studime të ndryshme ^[89,90,91,92,93,] vuri re se lidhja midis HbA1dhe malformacioneve është domëthënëse në tremujorin e parë, sidomos midis javës së peste dhe të tetë të shtatzënisë.

1.5.2 Ekografia

Ultrasound apo ekografia është ekzaminimi bazë në ndjekjen e zhvillimit embrional dhe më pas atij fetal. Një grua shtatzënë duhet t'i nënshtrohet rregullisht këtij ekzaminimi gjatë tremestrave, me anë të të cilit do të matën CRL, DBP, AC, kontrollohen RZF, likidi amniotik dhe placenta. Nën ekografi bëhen një sërë ekzaminimesh siç janë marrja e PAP-A, TRIPPLE TEST, amniocenteza mjaft të rëndësishme për formimin dhe zhvillimin e fëmijës.

Mjaft ndryshime që ndodhin në jetën intrauterinë vihen re me anë të ekografisë. Kështu që, në javët e para merr rëndësi të veçantë koha e dëgjimit të RZF-ve si dhe matja korrekte e CRL-ve për arsye të përcaktimit të saktë të moshës së gravidancës. Nga studime të ndryshme është vënë re se ka një korrelacion midis CRL-ve më të madhe se mosha e barrës me makrosomi apo diabet gestacional. Gjithashtu nga faktoret e riskut dihet se sindromi i ovarit mikrokistik (cikël i çrregullt) luan rol në diabetin në shtatzëni.

Shumicën e anomalive apo arsyt e ndërprerjes së shtatzënisë gjatë muajve të parë të shtatzënisë e mësojmë për herë të parë nga ekografia. Dokumentimi i çdo seancë ekografike në ecurinë e një shtatzënie zë vend të veçantë qofte kjo dhe tek personat e pariskuar për probleme.

Gjatë tremuajve të fundit të barrës, apo kryesisht pas muajit të 5-të të shtatzënisë (java e 24 –të) kontrolli ekografik i saktë, jep të dhëna të plota mbi sasinë e likidit amniotik, gradës së pjekjes placentare, peshën e bebit dhe pozicionin e tij. Është vërejtur se polihidramnioni ka lidhje të ngushtë me diabetin në shtatzëni ashtu si dhe makrosomia (fetus mbi 4000 gram) .

Në studime të ndryshme të zhvilluara mbi rëndësinë e ekografisë në ndërlikimet fetale tek shtatzënia diabetike ^[94] është theksuar se duhet të paktën dy ekografi në një distancë tre deri katër javore me bazë matjen e AC-së. Kjo matje vlerëson kryesisht mirëqenien fetale dhe parandalon LGA-te, nëse del mbi percentilen e 90-te ^[95].

Pikat e forta të ekzaminimit ekografik në shtatzëninë diabetike janë:^[96,97,98]

1. Monitorimi i mirëqënies embrionale dhe fetale prej javëve të para konceptionale
2. Analizimi i hershëm i anomalive fetale. (plotësimi i organogjenezës) Kryesisht, kjo procedohet gjatë javës së 16-te deri në 22-të të shtatzënisë. Në këtë periudhë kontrollohet:
 - uniformiteti i shtyllës kurrizore për të kapur në kohë spina bifida-n,
 - uniformiteti i kockave kraniale për të dalluar anëncefalinë,
 - vendosjen dhe pozicionimin e zemrës fetale
3. Analizimi i mirërritjes së fetusit në tremujorin e fundit duke ndjekur nga afër:
 - Zhvillimin fetal: përmasat e DBP-së, AC-së, plus peshën fetale për të parandaluar makrosominë apo për të mbajtur nën kontroll hipotrofinë.
 - Adnexet fetale ku hyn placenta dhe likidi amniotik. është vërtetuar ndryshimi i sasisë së likidit amniotik në shtatzënite diabetike. Xhepat e likidit të parëm ose të pasëm amniotik duhet të jenë sipas kritereve ekografike midis 4 dhe 6 cm, pa praninë në to të elemente të vogla siç mund të jenë gjymtyrët fetale, kordoni umbilikal etj nëse madhësia e tyre i tejkalon këto përmasa atëherë kemi të bëjmë me shtim të likidit amiotik dhe quhet polihidramnios. Ky mund të vihet re dhe më përpara tremujorit të tretë dhe është indikacion për një ekzaminim më të plotë të fetusit përse i'u përket anomalive ose një matje e përsëritur e glicemisë esëll.




Figura 6. Paraqitet xhepi i pasëm tek një gravidancë 28-29 javëshe, i cili i kalon 6cm pa pjesë të vogla në të

Sasia e likidit amniotik vlerësohet nga indeksi i likidit amnitik ose AFI, që është shuma e matjes së të gjitha kuadratëve me likid. Norma është 8.1-18 cm. Vlera nga 5-8 cm është oligoamnios ndërsa mbi 18cm është polihidramnios. Më pak se 5 cm është oligoamnios i rëndë. Praktikisht nëse madhësia e xhepave me likid amniotik është më pak se 4 cm dhe në të kemi praninë e pjesëve të vogla atëherë flasim për oligoamnios dhe duhet të kontrollojmë fluksin feto-amtar dhe cerebro-fetal për t'u siguruar se kemi një qarkullim të mirë dhe nuk jemi para një gjendje letale fetale siç është feti-morto in utero.



Figura7. Paraqitja e reduktimit te sasise së likidit amniotik tek një shtatzëni 20 javëshe

Në javët e fundit të një shtatzënie normale ose në raste të një patologjie shoqëruese siç është preeklampsia apo infesionet urinare ekografikisht kemi mundësi të kontrollojmë dhe shkallën e pjekjes placentare nëpërmjet ishujve të kalcifikimit. Sa më të shumtë në numër te jenë ata, sa më afër bazës placentare aq më e madhe është mundësia që fluksimetria të kompromentohet, sasia e likidit e ndryshuar dhe gjendja fetale e rënduar.

Gjithashtu në tremestrin e fundit është ekografia ajo që përdoret për monitorimin fetal me anë të fluksimetrisë Doppler dhe ndjekjes së levizjeve fetale aktive sic është gëlltitja.

Fluksimetria Doppler ose studimi i qarkullimit të gjakut fetal bëhet duke matur fluksin e dy arterieve kryesore, që sigurojnë mireqënien fetale: arteria umbilikale e cila tregon për rritje të rezistencës placentare dhe arteria cerebri media që tregon për hipoksi cerebrale. Kombinimi i tyre shërben për të ndjekur zhvillimin intrauterin në terren të ndërlikimëve të shtatzënisë nga preeklampsia, albuminuria, hipotrofia apo makrosomia.

Ndjekja e lëvizjeve aktive fillon prej javës së 29-te duke u munduar te ngacmohet fetusi për te vëzhguar lëvizjet e anësive të poshtëme dhe të sipërme, një lëvizje të diafragmës apo dhe një “gëlltitje” gjatë së cilës kontrollohen goja dhe ezofagu.




Figura 8. Ndryshimet placentare kalcifike të linjës bazale (majtas) dhe të gjithë placentës (djathtas)

1.5.3 Monitorim fetal

Monitorimi fetal përbëhet nga katër elemente kryesore të cilët mbikqyrin profilin biologjik dhe fizik të fetusit:

1. prania e ritmit kardiak fetal dhe normaliteti i tyre duke i dëgjuar me anë të kardiotocografit apo duke ndjekur me anë të ekografisë për një periudhë kohore të konsiderueshme (deri në 20 minuta)
2. prania e levizjeve fetale aktive: gëlltitje, frymëmarje aktive apo pasive; ndryshime në pozicionin, lëvizjet e gjymtyrëve
3. Bioprofilin për zhvillimin e fetusit me anë të matjes ekografike të AC-së dhe peshës fetale. Në raste të patologjive që rëndojnë në shëndetin e tij, këtu hyn dhe fluximetria Doppler
4. Përshkrimi i adnexeve: matja e xhepave të likidit amniotik, grada e pjekjes placentare

Monitorimi fetal bëhet një herë në muajin e tetë të shtatzënisë dhe çdo dy javë gjatë muajit të fundit, duke u shoqëruar minimalisht me një ekzaminim të plot laboratorike:

- a. gjak komplet

- b. urinë komplet
- c. glicemi esëll
- d. matjen e peshës trupore të gruas dhe vlerat e tensioni arterial

1.6 Pasojat e diabetit gestacional në jetën fetale intrauterine

Diabeti në shtatzëni është unike, sepse për nga shtrirja dhe ndryshshmëria e problemeve që ka, prek zhvillimin fetal prej fazës së konceptimit embrional ^[99]. Kontrolli i glicemisë amtare është vërtetuar se luan rol të rëndësishëm në malformacionet fetale. Ulja e vlerave të saj minimizon incidencën e tyre para javës së 9-të të shtatzënisë ^[100]. Frekuenca e komplikacionëve fetale në shtatzënite diabetike dhe malformacioneve të ndeshura në këto shtatzëni janë studiuar dhe vërtetuar prej autoreve të ndryshëm ^[101,102,103]. Këto paraqitje përfshijnë nga anomalite e vogla të shtatzënisë: aborte spontanë rekurrente deri në jetën neonatale: javën e katërt të jetës së pavarur. Kucera & al ^[104] nga vitet 1945 deri në 1965 në një grup kontrolli prej 7101 fetuse të nënave diabetike vuri re një përqindje prej 4.8 % të anomalive fetale . Kjo në kombinim me faktoret e riskut në disa zona shkon deri 5.2 – 16.8 përqind. Studime në shtrirje kohore kanë nxjerr rezultatë të ndryshme për sa i përket rolit që luan shtatzënia diabetike në procesin e organogjenezës dhe zhvillimit fetal por të gjitha kanë arritur përfundimin se: në shtazëninë diabetike rritet rreziku për të pasur probleme fetale, duke nisur nga anomalite deri në problemet në lindje e pas lindjes ^[105].

Shumë autore anomalitë e vëzhguara në një shtazeni diabetike ia dedikojnë efektit teratogenk të diabetit (të patrajtuar) apo ndryshime të niveleve të glicemisë në moshë të hershme të konceptionit ^[104,105,106]. Sistemi më i prekshëm nga luhatjet e glicemisë në shtazëninë diabetike është ai skeletor (vecanërisht vertebrat) ^[107], kardiak ^[108] (vecanërisht septumi), neural dhe central, gstrointestina dhe geniturinar. Disa anomali mund të kapin disa organe njëherazi dhe janë 13-50% letale ^[109].

Sipas një studimi në vitn 1958, Opitz^[110,111] nxorri një konkluzion se anomalitë multisistemale e kanë afinitetin e tyre :

- brenda javës së katërt të shtatzënisë, pra fazës së blastogenezës,
- momentit të inseminimit
- gastrulacionit, pra dita e 42 e amnerrohesë.

Kjo është vertetuar nga një grup tjetër studimi, i cili ka marrë në shqyrtim anomalite pas kontrollit në javën e 5-të të shtatzënisë. U vu re se anomalite në këto raste ishin më të larta dhe kishin korrelacion me hemoglobinën e glukozuar. Përfundimet për këtë dolën në vitin 1978 pas studimit të Lesli & al ^[89], i cili nxorri lidhjen midis nivelit të lartë të HbcA1-së dhe anomalive intrauterine sidomos te tremestrit të parë ^[85,86,87].

Në vitin 1970 Pedersen postuloi se: “Kompesimi metabolik jo i kompletuar nga diabeti amtar përgjatë javeve të para të shtatzënisë është shkaktari kryesor i malformacioneve madhore” ^[98]

Tabela 3. Të dhënat në përqindje të anomalive në diabetin gestacional sipas autoreve të ndryshëm.

Studimet	Numri i pacienteve	Përqindja
Ylinen et al ^[112]	11/142	7.7
Mills at al ^[103]	25/279	9.0
Greene at al ^[91]	35/451	7.7
Steel et al ^[90]	12/239	7.8
Fuhrmann et al ^[107]	22/292	7.5
Simpson et al	9/106	8.5
Albert et al ^[113]	29/289	10.0

1.6.1 Ndarja e anomalive sipas tremestrave

Gjatë tremestrit **te parë**, duke u nisur dhe nga sa u përmend me sipër përfshihen abortet rekurrente brenda javës se 13, missed abort dhe blighted ovum. Ekografia është një nga ekzaminimet baze të tremujorit të parë, kjo për disa arsye:

- ❖ Matja e CRL brenda javës se 10-të ul mundësinë e gabimit të përcaktimit të datës së përfaqësimit të lindjes, pasi në pacientet me dëmtim të tolerances së glukozes kemi një rritje të shfaqjes së sindromit të ovarit microkostik, pra çrregullimit të ciklit.
- ❖ Vlerat e CRL-së korrespondojnë me rritjen fetale në vazhdim. Pra nëse kemi të bëjmë me një vlerë të rritur të CRL për moshën e barrës atëherë ky rast duhet ndjekur nga afër, sepse ka probabilitet për një makrosomi të mundshme në fund të shtatzënisë
- ❖ Kapja në kohë të hershme e missed abort apo të blakid ovum

Në shumicën e rasteve në këtë periudhë të shtatzënisë është ekografia ose klinika (fillimi i hemorragjisë) që i paraprin vendosjes së diagnozës për një diabet gestacional. Supozohet se hiperglicemia rrit rrezikun në zhvillimin e yolk sac ^[114], duke rritur prodhimin dhe çlirimin e radikaleve e lira të O₂, mungesën e myoinositolit dhe acidit arachidonik në transmetimin e sinjaleve në rritjen qelizore duke çuar kështu në embriopati brenda javëve të para të shtatzënisë. Aborti spontan tek gratë jo të riskuara me diabet ose që nuk kanë diabet, ka një incidencë 15.3% deri në javën e 20-te. ^[129].

Autorë të tjerë në varësi të studimit: prospektiv apo retrospektiv, që kanë bërë kanë nxjerrë përfundime të ndryshme.

Tabela 4. Incidenca e abortit spontan në shtatzënitë me diabetin gestacional

Studime	Diagnoza	Mosha e barrës	Incidenca
Wright&al ^[115]	Klinike	Më pak se 14	17.2
Miodovnik&al ^[116]	Klinike	Më pak se 9	22.4
Mills&al ^[117]	Ekografi	Më pak se 6	15.5
Greene et al ^[95]	Ekografi	Më pak se 13	17.2
Hanson&al ^[118]	Klinike	Më pak se 16	7.7
Rosenn&al ^[119]	Klinike	Më pak se 9	26.2

Në rolin që luan diabeti gestacional përsa i përket abortit rekurent apo miscarriage nuk ka shifra ekzakte por është vertetuar se me rritjen e vlerave të HbcA1 në javën e 5-të deri të 8-te të shtatzënisë rritet dhe mundësia për të pasur një ndërprerje të saj ^[116]. Humbjet e shtatzënisë tek një shtatzëni diabetike janë vertetuar të jetë 4-5 fish me të larta se në popullatën normale ^[116], ndërsa tek pacientet me diabet për një kohë të gjatë (>10 vjet) dhe të kontrolluar dobët (HbcA1 tejkalon 11%) kanë shfaqur një normë aborti deri në 44 %.

Ndikimi i diabetit është mjaft i ndjeshëm në zhvillimin placentar dhe marrjen e funksionit të saj që ndodh brenda tremestrit të parë^[129] Është venë re, se rritja e glicemisë ndikon në modifikimin e strukturave placentare, duke reduktuar proliferimin trofoblastik e me pas rritjen placentare dhe zhvillimin. Ky mekanizëm mund të shpjegojë incidencën e lartë jo vetëm të aborteve spontanë, por edhe të preeklampsisë dhe hipotrofisë fetale që shoqëron diabet gestacional në tremestrin e tretë ^[120].

Hidden et al ^[121] propozuan një hipotezë përsa i përket ndikimit të placentes në tremestrin e parë. Kjo i dedikohet lidhjes që u vu re ndërmjet rritjes së nivelit të TNF- α dhe abortit të hershëm rekurent. Hiperglicemia matërnë indukon trashjen e membranës bazale placentare duke ulur transportin e oksigjenit (O₂) në të.

Për këtë arsye ndjekja rigoroze e nivelit të glicemisë prej javeve të para të shtatzënisë apo në periudhën prekonceptionale tek të gjitha gratë, por sidomos tek ato të gra të riskuara për diabet gestacional është mjaft e rëndësishme në parandalimin e komplikacionëve të tilla.

Gjatë **tremestrit të dytë** komplikacionët fetale të shtatzënisë diabetike përfaqësohen nga anomalitë në zhvillimit të fetusit, të cilat siç u përmendën dhe më lart janë të konsiderueshme. Risku i lartë i këtyre shtatzënive për anomali duket të jetë i lidhur me faktin e një kontrolli të varfër glucidik përgjatë tremujorit të parë ku dhe ndodh organogjeneza.

Rritja e rasteve me anomali të tubit neural apo kardiovasulare tek gratë me diabet ekzistues është fakt që tregon se niveli i lartë i glicemisë apo i hemoglobinës së glukozuar në gjak ka lidhje të drejtpërdrejtë me përqindjen e anomalive të këtij lloji. Deri tani nuk është vertetuar agjenti teratogen që ndikon direkt në zhvillimin e këtyre anomalive. Në studime të ndryshme ka rezultuar një rritje e përqindjes së anomalive deri në 50 % tek gratë të cilat i janë nënshtruar kontrollit prekonceptional dhe gjatë tremestrit të parë të vlerave të glicemisë. Gati dy të tretat e anomalive, që përfshijnë këto sisteme u

përkasin pacienteve me tolerance të dëmtuar të glukozës ose të njohura me diabet. Defektet e tubit neural ndodhin 13 deri në 20 herë me shpesh tek shtatzënite diabetike. Nga *Pedersen et al., Lancet, 1964*.^[122] kemi të publikuar rezultatët e një studimi mbi anomalite në lindje midis grave me diabet gestacional dhe jo me diabet gestacional (tabela). Ndryshimi midis tyre është gati në trefish të vlerave të marra.

Tabela 5. Tabeta paraqet anomalitë kongenitale sipas Pedersen ^[123]

	Nr i pacienteve	Nr. i anomalive kongenitale		
		Numri i anomalive	Te mëdha	fatale
Lindje nga gra GDM+	853	55 (6.4%)	44 (5.2%)	18 (2.1%)
Lindje nga gra GDM-	1,212	26 (2.1%)	14 (1.2%)	4 (0.3%)

Nga studime të tjera të kryera nga autore të ndryshëm janë marrë në konsideratë llojet e anomalive me të shfaqura tek gratë me diabet gestacional. Variabiliteti i tyre është paraqitur në tabelën e mëposhteme:

Tabela 6. Paraqet studimet për anomalite sipas organeve dhe/ose sistemeve që prek diabeti gestacional.

Studimet autor/vend	Sistemi neural	Sistemi kardiovaskular	Sistemi gastrointestinal	Sistemi geniturinar	Sistemi kockor	paciente
Kucera et al / Europë ^[96]	4.6	5.6	3.2	4.7	20.7	3565/350010
Neave et al/ Amerike e veriut ^[124]	3.3	6.1	4.3	2.3	15	2592/2592
McCarter et al/Baltimore ^[125]	3.1	2.0	3.7	3.2	2.0	312/914
Becerra et al/ Atlanta ^[126]	15.5	18	-	-	-	28/3029
Bower et al / Australi ^[127]	3.5	4.4	-	-	3.2	214/110592
Martinez-Frias et al/ Spanjë ^[128]	2.9	2.8	-	3.8	5.2	76/18683

Në anomalit= me të shprehura përfshihen :

- skeletor: spina bifida, anencefal, hidrocefali dhe mikrocefali
- kardiovaskular: kardiopati, transpozicion kardiak, koarktacion te aortes, defekt septumit atrial ose ventricular, hipertrofi asimetrike e septumit.
- Gastrointestinal: atrezi të ezofagut, duodenit, rektumit dhe anusit
- Genitourinary: ren kistik, agenezi renale, hidronefrozë, ureter duplex

Edhe në këtë tremestër venia në dukje e anomalive është në saje të ekografisë, e cila zbulon difektet kryesore. Megjithëse nuk përjashtohen raste të mosdiagnostikimit për arsye të ndryshme, kur këto fetuse vazhdojnë zhvillimin intrauterin dhe kanë përfundim fatal oret e para të lindjes .

Kompikacionët fetale të **tremestri të tretë**, janë ë tepër pasojë e patologjive shoqëruese të kësaj periudhë. Ndryshimet e niveleve të glicemisë amtare janë të shoqëruara me ndryshimet në insulinemisë

fetale. Është venë re se ky korrelacion fillon prej tremujorit të dytë dhe pasoja me madhore e tij është makrosomia. Por nuk përjashtohen dhe dëmtimet në organet amtare. Ndryshimet që ndodhin në organizmin amtar si rezultat i prishjes së zinxhirit të metabolizmit glucidik, japin rritje të katëkolaminave, që akuzohen për dëmtimet e para renale. Nuk është kuptuar akoma baza e ndryshimeve të tensionit arterial tek diabet gestacional, por duket se është e lidhur ngushtë insulin-rezistencën e shfaqur në këto shtatzëni si dhe tendencën për obezitetet. Parametrat laboratorike kanë treguar për korrelacion midis rritjes së insulinës, lipidemisë, TNF- α ^[130]. Në një shtatzëni normale kemi rritje të filtrit glomerular 30-50%. Tek një grua me ndryshime të glicemisë dhe kontroll të ulët të insulinës kjo rritje kap vlera akoma me të larta duke u shfaqur me format e infeksionëve të shpeshta urinare dhe albuminuri. Një studim i mbivendosur rast – kontroll^[131] tregoi se një tjetër faktor rreziku për zhvillimin e diabetit gestacional është prania e hipertensionit para shtatzënisë apo gjatë shtatzënisë së hershme. Pacientet me hipertension kronik gjatë diabetit gestacional, janë në rrezik të lartë të shfaqjes së hypotrofisë fetale, preeklampsisë së mbivendosur, distaco placentare apo dhe hipertensionit malinj të nënës. Rreziku i preeklampsisë gjithashtu rritet me moshën e nënës dhe kohëzgjatjen e diabetit është vënë re së shkalla e preeklampsisë korrelohet me nivelin e glicemisë. Në një studim^[132], kur glicemia esëll (FPG) ishte <105 mg/dL, shkalla e preeklampsisë ishte 7.8%, me një FPG >105 mg/dL, shkalla e preeklampsisë ishte 13.8%. Në po këtë studim indeksi i masës trupore (BMI) pregravidare ishte gjithashtu i lidhur në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e preeklampsisë.^[133]

Incidenca e makrosomisë varion nga 20 në 45% tek shtatzënite e padiagnostikuara (patrajuara) ndërsa 6 përqind tek shtatzënitë e trajtuara për diabet gestacional kundrejt 2% të shtatzënive normale. Foshnjat e nënave me hypërglycemi kanë të dyfishtë rrezikun e traumave në lindje, të trefishtë mundësinë e lindjes me s/cezarea dhe rrit 4 herë mundësinë e kalimit të bebit në reanimacionin neonatal për arsye të rrisqeve postnatale. Makrosomia fetale shoqërohet me organomegali si rezultat i fetopatise diabetike.^[134] Studimet tregojnë se rreziku i komplikacionëve është në proporcion me shkallën e hiperglicemisë së nënës. Landon & al^[135] raportoi se pjekuria e mushkërive fetale ndodh më vonë në shtatzënite diabetike të pakontrolluara, pavarësisht nga shkalla e diabetit.

Një vend të veçantë tek komplikacionët e tremetrit të tretë janë ndryshimet e placentës dhe likidit amniotic. Duke u nisur nga fispatologjia e diabetit gestacional, ndryshimi i prodhimit të hormonit placentar dhe ndryshimi i niveleve të leptinës bejnë trashjen e pjesës bazale të placentes, rrit proliferimin vazal duke sjellë me vete ndryshimet e dukshme placentare që janë rritja e volumit të saj, rritja e shkëmbimit të elementeve ushqyese nga nëna ke fetusit, shtimi i likidit dhe peshës fetale.^[136]

Lindja prematur tek shtatzënite diabetike është në shumë raste një mjet mbrojtës i organizmit amtar për të shpëtuar fëmijën. kjo ndodh midis javës 35-37 të shtatzënisë me fillimin e aktivitetit të lindjes. Mekanizmat që e vendosin në levizje janë:^[137]

- a) rritje e madhe e peshës së fetusit, distendimi i murit uterin
- b) rritja e polihidramnios, distendimi i membranave dhe ruptura parakohe e tyre
- c) ndryshimet placentare drej kalcifikimit, ulja e fluksit
- d) rritja e rrezikut të fetusit për hipoksi në rastet e hipotrofisë, që con në feto-morto.

Fëmija e një shtatzënie diabetike mund të jetë LGA^[138] dhe si i tillë ka nevojë për reanimacion neonatal menjëherë pas lindjes për arsye të ndërlikimeve që vijnë si rezultat i jetës intrauterine: çrregullime në metabolite, hipoglicemia, sindromi i membranave hialine, etj

Në studime të kryera pas viteve '90 referimet mbi komplikacionet e tremestrit të tretë përqendrohen kryesisht në dhënien e diferencave midis shtatzënive të pandërlikuara me diabet dhe ato që kalojnë diabetin gestacional. Disa referime janë:

- rritja e incidencës së infeksioneve urinare dhe genetike (te cilat mund të kenë filluar prej muajve të mëparshëm). Kjo incidencë arrin deri në 27% tek shtatzënitë diabetike
- preeklampsisë, me bazë nefropatinë. Preeklampsia është më e shpështë tek gratë me diabet (përafërsisht 12 deri në 20 %) kundrejt popullsisë pa diabet (5 deri në 8%). Hipertensioni kronik komplikon përafërsisht 1 në 10 shtatzënite diabetike.
- hypotrofia fetale (si rezultat i preeclampsise ose lindjes parakohe)
- ndryshimet e sasisë së likidit si polihidramnios 7% e shtatzënive diabetike ose oligoamnios 6%.
- Lindjet premature ndodhin në 6.2 % të lindjeve me diabet gestacional.
- Makrosomia fetale është komplikacioni më i shpështë në shtatzëninë diabetike. Rreth 50% e lindjeve nga shtatzëni diabetike janë fëmijë makrosome^[137]

Në terësinë e vet shtatzënia diabetike paraqet një shtatzëni të ndërlikuar prej fillimit të saj dhe deri në përfundim të lindjes .Po në komplikacionet e tremestrit të tretë shumë autore apo studiues përfshijnë dhe mënyrën e lindjes dhe traumat gjatë saj^[138]. Duke pasur parasysh përmasat fetale tek një shtatzëni diabetike sidomos në ato të pakontrolluara lindja përfundon në 50-60% të rasteve me ndërhyrje kirurgjikale^[139], sectio/cezarea për të mënjanuar epiziotomitë dhe laçeracionet vaginale, mjaft

traumatizuese për jetën e metejshme të gruas por nga ana tjetër dhe për të ndihmuar fëmijën të lindë sa më konfort. Kjo është vënë re në rritjen e apgarit fetal tek lindjet me operacion.

Por vitet e fundit duke qenë se është rritur mundësia e kontrollit të niveleve të glukozës shtatzënia diabetike mbahet nën një kontroll më të rreptë dhe si për pasojë edhe makrosomia. Kjo ka çuar në uljen e numrit të lindjeve me intervent. Në shumë studime sot ajo qëndron në vlerat e 20 përqind dhe insiston në rastet me komplikacione të rënda për fëmijën .

KAPITULLI II

TE DHËNA RRETH STUDIMIT TE NDËRMARRË

2.1 Qëllimi:

Studimi i ndërlikimeve apo pasojave intrauteinë të fetusit sipas tremestrave tek shtatzënitë diabetike të ndjekura pranë spitalit rajonal të Durrës, në periudhën kohore 2012-2014 .

2.2 Objektivat

- Njohja me pasojat fetale sipas tremujorëve tek gratë me diabet gestacional
- Nxjerrja e statistikave për pasojat fetale intrauterine në shtatzëninë diabetike në rrethin tonë.
- Kryerja rregullisht e testeve me glukozë orale në tremestrin e dytë dhe e glicemisë në çdo trimester.
- Plan projekt për një protokoll ndjekje të gruas në shtatzëninë diabetike.
- Incidenca e diabetit gestacional për rrethin e Durrësit

2.3 Hipoteza e këtij studimi

- Rritja e paritetit sjell rritjen e ndryshimeve të glicemisë, con në rritjen e probabilitetit për të kaluar diabet gjatë shtatzënisë.
- Prediabeti dhe diabeti lidhet ngushtë me shtimin në peshë të nënës dhe bebit
- Aborti rekurent ka lidhje me prediabetin dhe diabetin gestacional.
- Moszbatimi i protokollit të ndjekjes me ekzaminimet përkatëse të nivelit të GE vjen nga mungesa e informimit të i grave.

2.4 Metodatat e studimit

Rishikimi i literaturës si dhe ndryshimeve i niveleve socio-ekonomike bën të domosdoshme që herë pas herë të bëhen kërkime dhe studime të reja mbi korrelancat e diabetit gestacional (përgjatë shtatzënisë), e sidomos ndikimi i tij tek shëndeti i nënës apo fetusit – fëmijës së ardhshëm. Kjo është akoma më e vështirë për shkak të mungesës së studimeve të mëparshme mbi këtë fushë brenda vendit tonë.

Pas përpunimit parësor të të dhënave të marra nga pacientet, u veçuan personat me risk, dhe u kategorizuan në varësi të tremujorëve të shtatzënisë. Të dhënat u punuan në tabela statistikore krostabulat, ku numri i përzgjedhur i pjesëmarrësve me prediabet apo diabet gestacional u shoqërua me faktorin e rrishtit për të analizuar lidhjen korrelative në popullatën tonë (chi square test χ^2).

2.4.1 Periudha kohore e studimit

Studimi është shtrirë në një periudhë kohore prej 27 muajsh, Janar 2012 deri në Prill 2014.

2.4.2 Vendi i studimit

1. Qendra e gruas
2. Reparti i gjinekologjisë
3. Reparti i patologjisë së barrës
4. Reparti i lindjeve

Pranë klinikës obstetrik-gjinekologjike, Spitali Rajonal Durrës

2.4.3 Variablat socio-demografike

Gjinia: në rastin tonë gjinia është variabël unike femëre;

Mosha: sipas raportimit të pjesëmarrësve të përfshirë në studim. Mosha u trajtua si ndryshore (variabël numerike (i vazhdueshëm) dhe më pas u kategorizua në grup-mosha (variabël ordinale): nën 20 vjeç, 20- 30 vjeç dhe mbi 30 vjeç

Variablat e varur : Niveli i glicemisë

Në bazë të niveleve të glicemisë esëll ose pas ngarkesës është bërë ndarja në diabet gestacional dhe

prediabet.

2.4.4 Aprovimi etik është marrë nga Departamenti i Gjinekologjisë dhe Obstetrikës, Klinika e patologjisë së barrës pranë maternitetit të Qarkut Durrës.

2.4.5 Miratimi i informuar

Të gjitha pjesëmarrëset u vunë në dijeni të procedurave që duhej të plotësonin në mbushjen e kartelës tip si dhe në paraqitjen e rregullt për t'u plotësuar me ekzaminime. Çdo gjë është bërë në konfidencialitet dhe në dëshirën e tyre të lirë. Për këtë arsye dhe plotësimi i protokollit të vendosur gjatë ndjekjes së shtatzënisë nuk është plotësuar konform nga të gjitha pjesëmarrëset.

2.4.6 Popullata në studim

Janë marrë në studim të gjitha gratë e paraqitura në mënyrë rastesore pranë :

1. Qendrës së Gruas për të kryer ekzaminimet të protokollit rutinë të shtatzënisë
2. Gratë që janë hospitalizuar në repartin e patologjisë së barrës .
3. Si dhe gratë që kanë lindur pranë maternitetit tonë.

Në varësi të korrelacionëve të nxjerra gjatë studimit, ndarja në grupe të popullatës është bërë

- a) Në varësi të grup-moshave në lidhje me nivelin e glicemisë esëll
- b) Numrit të paritetit në lidhje me nivelin e glicemisë

e cila është e ndarë kjo sipas tremestrave të shtatzënisë.

Përgjatë tremestrit të tretë është marrë në konsideratë edhe:

- a) përfundimi i lindjes,
- b) Shtimi në peshë, i mbështetur në indeksin e masës trupore (ITM),
- c) Komplikacionët amtare; të lidhura këto me nivelet e glicemisë esëll.

2.4.7 Kriteret e përzgjedhjes

Janë zgjedhur rastet të cilat:

- 1) Kanë më shumë se një analizë glicemie esëll dhe biometrinë ekografike në shtatëzanin e tyre
- 2) Kanë zbatuar protokollin e ndjekjes së shtatëzaniës për te pakten një trimester te plotë
- 3) Ka monitoruar në mënyrë te rregullt gjendjen e saj dhe te femijës për atë periudhë shtatëzanie.

Kriteret e përjashtimit

- 1) Kanë qënë të diagnostikuara me diabet mellitus
- 2) I nënshtroheshin terapisë me insulinë dhe ishin nuligravida.
- 3) Për arsye private kanë zgjedhur mos përfundimin e monitorimit të tyre në spitalin e Durrësit

2.4.8 Ekzaminimet bazë te përzgjedhjes

1. Glicemi esëll
2. Prova e ngarkesës me glukozë orale 50 mg , ky test u zbulua nga O’Sullivan et al. dhe konsiston në marrjen nga goja te 50 gr glukozë dhe matjen e niveleve të glicemisë pas 1 ore (GCT). Gratë që dalin positive nga ky test duhet t’i nënshtrohen marrjes se 75 gr glukozë orale (OGTT), ku matja do te behet pas 1, 2, 3 orësh. Niveli i glicemisë 1 ore pas marrjes mbi 140 mg /dl do te n’a japë rezultat pozitiv ^[9].

Tabela7. Paraqitja e moderuar e përfundimeve nga testi i ngarkesës me glukozë (GCT) sipas kriterëve 2014

Koha e matjes	Vlera e glicemisë mg/dl	Mmol/l
Esëll	95	5.3
Pas 1 ore	180	7.8
Pas 2 oresh	140	6.7

2.4.9 Metoda e marrjes së glukozës

Për arsye të mungesës në laborator privat dhe shtetëror të glukozës orale në proven e ngarkesës nuk u praktikua monstra e glukozës orale as dhe monomerit të glukozës .

Prova e ngarkesës me glukozë është bërë duke tretur 75 mg sheqer në 200 ml ujë tetë bustina sheqer). Marrja e monstrave të gjakut për ekzaminim është bërë pas 2 orësh.

2.4.10 Ekzaminimet rutin

Marrja e vlerës së hemoglobinës së glukozuar, HbA1-së, për arsye të mungesës së reagenteve në mjediset spitalore është bërë në mënyrë privatë me mundesi individuale. Është munduar të përzgjidhen për këtë midis pacienteve me anamnëze të riskuar.

2.4.11 Tipi i studimit

Është zgjedhur tipi i studimit *kros-seksional*, sepse përshkruan shumë mirë shpërndarjen e njëkohëshme midis ekspozimit dhe ngjarjes shëndetësore në popullatë. Ky tip studimi është vecanërisht i dobishëm për sëmundjet e shpeshta si është diabeti, duke marrë parasysh këtu dhe kohëzgjatjen e madhe të kësaj patologjie.

2.4.12 Analiza statistikore

Në analizimin e të dhënave u përdorën programet informatike SPSS V.17 (Statistical Package for Social Sciences, version 17.0, Chicago, IL) dhe EXCEL për paraqitjen grafike të të dhënave.

Analiza epidemiologjike u krye në varësi të kohës dhe personit. Variablat e pandryshuar si mosha u krahasuan me variablat e ndryshueshëm më anë të krostabulateve.

Për paraqitjen e frekuencave kemi përdorur bar diagramën sepse duam të tregojmë dinamikën e fenomenit të obezitetit në jetën e pjesmarrësve edhe sepse pjesërisht e të dhënat tona janë diskrete.

Përdorem tabelën 2x2 duke kombinuar të dhënat e grumbulluara për të parë lidhjet e mundëshme midis indeksit të masës trupor, moshës, paritetit.

Gjithashtu është kombinuar niveli i glicemisë me numrin e komplikacionëve nga diabeti, peshën e gruas, peshën fetale etj.

Në çdo krostabulat të paraqitur më poshtë është përdorur testi i pavarisë X^2 ose chi square sepse n'a lejon krahasimin e dy propociove. Përdoret ky test statistikor sepse vlera e pritshme është më e madhe se dy. Niveli i sinjifikancës 0.05 shërben për te përcaktuar vlerën e testit chi square që bën të mundur hedhjen poshtë apo mbajtjen e hipotezës bazë zakonisht.

Një alternative tjetër krahasimi midis diabetit gestacional e prediabetit është raporti i gjasave. Për shkak se studimi ynë transversal ose kroseksional dhe në pamundësi te njësimi të rrezikut relativ, përdorim raportin e gjasave si madhësi njësuere e shoqërimit midis diabetit gestacional dhe faktorëve te mundshëm që kanë ndikuar në këtë patologji.

Kur flasim për problemet e shtatzënisë, studimi n'a jep informacionë relative sa i përket ekspozimit që pjesmarrëset kanë nën ndikimin e diabetit apo prediabetit.

Raportin e gjasave gjithashtu e kemi përdorur në ato raste kur vlera e probabilitetit pas aplikimit të testit chi square ka rezultuar statistikiisht jo sinjifikante.

2.4.13 Hapat e studimit

Të gjitha pacientet kanë plotësuar **kartelen tip** për marrjen e të dhënave të anamnezës vitae dhe asaj obstetrikale. Përmbledhja e pyetesorit në kartelën tip u bë duke iu referuar studimeve të ngjashme ndërkombëtare të paraqitura në konferenca apo takime pune të ndryshem, duke ecur sipas pikave bazë ku ishin mbështetur autorët për të nxjerrë rezultatët. Në përpilimin e saj u morr parasysh dhe konkretizimi i objektivave që i kishim vendosur këtij studimi apo konkluzioneve që do të nxirreshin në fund të tij (shtojca 1).

Nga numri i përgjithshem i formulareve janë marrë parasysh vetëm rastet që janë ndjekur në mënyrë korrekte të paktën për një trimester te plotë .

Rastet e mbledhura u ndanë sipas tremestrave .

U analizuan dhe u vecuan të gjitha komplikacionët në kohën përkatëse kur kishin ndodhur.

Kriteret që duhet të plotësonin pacientet në fund të studimit ishin:

1) Anamnezë e ngarkuar familjare me histori të diabetit në brezin e parë (moter, vëlla, nënë, baba)

- 2) Vlera mbi 95 gr/mL të glicemisë esëll
- 3) Prania në anamnezën obstetrikale e feto-morto in utero, fëmijë me peshë mbi 4000 gram, me shumë se një aborti spontan.

Të gjitha të dhënat u rigrupuan sipas tremestrave në tabelat Excel prej dhe nga dolën rezultatët statistikore. Më pas u punuan në tablat e krosstabulatëve, ku numri i përzgjedhur i individeve me prediabet apo diabet gestacional u shoqërua me faktor risku për të parë korrelacionët në popullatën tonë.

Në përfundim të nxjerrjes së konkluzioneve, në baze të formulareve e mbledhur dhe pjesëmarrjes së grave është nxjerrë dhe shkalla e sensibilizimit për këtë patologji në popullatën e rrethit të Durrësit.

Tabla 8. paraqet kartelën standartizuar në të cilën jemi bazuar për të grumbulluar disa të dhëna

Data...../...../.....	
Emër	
Mbiemër	
Datëlindja	
Vendbanimi	
Numri i kontaktit	
Anamneza familjare për diabet:	
JO <input type="checkbox"/>	Përsional <input type="checkbox"/> Nëna <input type="checkbox"/> Babai <input type="checkbox"/> Moter <input type="checkbox"/> Vëlla <input type="checkbox"/>
Anamneza obstetrikale	
Pesha e gruas (në kg)	
Pariteti	
Mënyra e lindjes	Normale <input type="checkbox"/> s/cezare <input type="checkbox"/>
Pesha fetale (në gram)	
Abort(tremestri i parë)	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Missed abort	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
miscarriage	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Abort (tremestri i dytë)	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Anomali kongenitale	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
partus premature	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
preeklampsia	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Të dhënat laboratorike	
	Tremestri I Tremestri II Tremestri III
Vlerat e glicemisë esëll	
HbcA1-ja	
Prova e glukozës	
Të dhënat ekografike	
	Tremestri I 14-22 javë 23-32 javë 33-39 javë
CRL / RZF	
BDP	
Sasia e likidit amniotik	
Placenta	
Pesha fetale	

2.4.14 Grupimi i të dhënave studimore

Për pacientet që kanë përfunduar shtatzëninë e tyre brenda tremestrit të parë, kartela tip e të dhënave është plotësuar deri në javën e ndërprerjes së shtatzënisë. Duke qenë kohë relativisht e shkurtër pasi nuk kemi të bëjmë me grup të përzgjedhur paraprakisht, ekzaminimet e nxjerra përfshijnë një analizë të glicemisë esëll, një ekografi ku vërtetohet ndërprerja e shtatzënisë dhe arsyeja e saj dhe në disa raste hemoglobina e glukozuar. Përqindja me e madhe në këtë grup është grupi i riskut .

Për pacientet që përfunduan shtatzëninë e tyre para javës së 22-të të shtatzënisë hapat e ndjekura janë të njëjta me ato të tremestrit të parë .

Në të dyja këto grupe u protokolluan të dhënat e u vecuan rastet që kishin vlerën e GE mbi 95 mg/dl ose hemoglobinën e glukozuar me shumë se 6.

Të gjithë pacientet që arritën në javën e 22 –te të shtatzënisë iu nënshtruan provës së ngarkesës me 75 mg polimer të glukozës . Tek personat me testin GCT pozitiv u përserit prova me 100 mg glukozë orale. Përveç diabetit gestacional në këtë studim është marrë parasysh dhe termi i prediabetit , i futur në nozologji prej viti 2008, i cili quan të riskuar çdo rast me glicemi esëll mbi 95 mg/dl, por me të ulët se 110 mg/dl, dhe këshillon përseritjen e ekzaminimeve në këto raste si dhe provat e ngarkesës me glukozë orale 75 dhe 100 mg midis javës së 24 - 28 të shtatzënisë. (shih tek fq 16)

2.4.15 Të dhëna të përgjithshme për subjektet në studim

Në kapitullin pasardhës janë paraqitur të gjitha gjetjet e arritura, duke qartësuar kështu më shumë hipotezën mbi të cilin është ngritur studimi. Rezultatët janë përfutur nga analiza statistikore e të dhënave të grumbulluara nga vlerësimet me pacientet.

Të dhënat janë paraqitur në tabela dhe grafikë, duke vlerësuar variablat sipas rasteve dhe përqindjeve. Gjithashtu paraqitja grafike qartëson ndryshimet e ndodhura. Paraqitja e tyre është zgjedhur e formave të ndryshme për të bërë sa më të qarta ndryshimet e vëna re.

Ndryshimet janë paraqitur në përqindje për të gjithë kategoritë në studim dhe krahasueshmëria e gjetjeve tregon dallimin midis variablave.

- Janë paraqitur pranë shërbimeve të gjinekologjisë (aktualisht reparti i patologjisë së barrës së vogël) për patologji të tremestrit të parë, për të njëjtën periudhë kohore, 1954 gra; prej të cilave 1780 prej tyre kanë patur një nga diagnozat: missed abort, blighest ovum apo abort të formave të ndryshme (incipient, progredient, incomplet, beance c. uteri,etj)
- Janë regjistruar 44 anomali kongenitale të kësaj periudhë kohore përsa i përket tremestrit të dytë ndërkohë që për këtë trimester janë hospitalizuar 196 gra.
- Janë paraqitur pranë shërbimit të patologjise së barrës për patologji të shtatzënisë rreth 3268, prej të cilave janë monitoruar dhe kanë rezultuar në baze të ekzaminimeve 163 me prediabet dhe diabet në shtazani.
- Gjatë kohës së studimit numri i popullatës së paraqitur pranë spitalit për arsye obstetrikale arrin në 5970. Nga këto 5730 janë lindje të kryera pranë shërbimit obstetrikal të këtij matërniteti. Nga këto në 480 lindje, fëmijë kanë qenë me peshë 4000 gr e sipër .

KAPITULLI III

REZULTATET E STUDIMIT

3.1 Tabelat përshkruese për tremestrin e parë: Pasojat intrauterine tek embrioni deri në javën e 14-të të shtatzënisë

Përmbledhen në diagnozat:

a.Missed abort (miscarriage) b.blighest ovum dhe c.abort spontan rekurrent

1. Numri total i grave të shtruara në gjinekologji me diagnozë: *abort (incipient, progredient, incomplete), missed abort dhe b.ovum* për periudhë kohore Janar 2012 – Prill 2014 është 1954.
2. Numri i pacienteve të diagnostikuara dhe të ndjekura ambulatorisht me diagnozë: *abort incipient* midis javës së 5-të dhe të 14-të të shtatzënisë (pa probleme hemorragjie) është 1176 gra.
3. Numri i grave të kontrolluara gjatë kësaj periudhë shtatzënie, me ekografi dhe ekzaminim laboratorik për vlerat e glicemisë (minimalisht një matje) është 1085 gra, prej tyre 976 gra të hospitalizuara dhe 109 ambulate.
4. Gratë që kanë bërë ekzaminimin e HbA1c-së është 769 nga të cilat 544 kanë qënë nga pacientet e hospitalizuara dhe 225 ambulator. Prej tyre me vlerë më të lartë se 6 kanë rezultuar vetëm 14 raste, tek të cilat është ripërsëritur prova dhe ekzaminimi.
5. Gratë që kanë përfunduar shtatzëninë e tyre brenda tremestrit të parë në abratio mucosae cavi uteri për shkaqe të ndryshme është 927 raste, prej të cilave 92 raste janë NVB.

Në bazë të këtyre rezultatëve vihet re se :

Në 1085 paciente që pranuan të plotësonin kartelen tip gjatë tremestrit të parë, 67 paciente me ndryshim të niveleve të glicemisë (kryesisht prediabet), përfunduan shtatzëninë e tyre brenda këtij tremestri në abratio cavi uteri ose 6.1%




Figura 9. Vendi që zenë pasojat fetale të shtatzënisë diabetike gjatë tremestrit të parë.

Në përpunim të të dhënave statistikore u bë grupimi në varësi të grupmoshave dhe të paritetit të cilat u krahasuan me nivelet e glicemisë dhe u paraqiten në formën e tabelave dhe të grafikeve linëare të mëposhtëm.

Tabela 9. Paraqet ndarjen sipas grupmoshave të pasojave fetale të tremestrit të parë të lidhuara me ndryshimet e glicemisë.

Moshë e femrës	Niveli i glicemisë	Total
	Prediabet	
<20 vjeç	12	12
20-30 vjeç	38	38
>30 vjeç	17	17
Total	67	67

Në tremujorin e parë të gjithë rastet janë prediabetike. Variabli “Niveli i glicemisë” është konstant .

Nëse do të shihnim shtrirjen në grupmoshe do të vinim re një grupim me të madh tek grupmosha 20-30 vjec dhe kjo për dy arsye :

1. grupi me i interesuar për t’u pajisur me ekzaminime
2. grupi me i madh në moshen fertile në popullatë




Figura 10. Paraqija e shpërndarjes sipas grupmoshave të rasteve në studim

Përsa i përket përqindjes së zenë pacientet me ndryshim të nivelit të glicemisë në totalin e atyre që kanë përfunduar shtatzëninë e tyre brenda këtij tremestri, sipas diagnozave përkatëse kemi këtë shpërndarje:

Tabela 10. Paraqet shpërndarjen sipas diagnozave për paciente me glicemi esëll mbi 95 mg/dL

Diagnoza:	Numri i rasteve(total)	Numri i rasteve(GD)
Missed abort	423	28 pacient me GE mbi 95 mg/dL
Blighest ovum	173	11 pacient me GE mbi 95 mg/Dl
Abort rekurente	205	28 pacient me GE mbi 95 mg/Dl

Kuptohet që në grupin e tretë, atë të aborteve rekurrente, ka përfshirje nga te dy grupet e para. Kjo con në faktin që gati 48 % e grave me ndryshime të glicemisë ose me diabet të patrajuara bejnë aborte rekurente të kësaj periudhë.




Figura 11. Paraqitja e shpërndarjes së rasteve me diabet gestacional të ndara sipas diagnozave

Tabela 11. Paraqet krahasimin midis paritetit të pacienteve dhe nivelit të glicemisë (tremestri i parë)

Pariteti	Niveli i glicemisë	
	Prediabet	Total
Primipare	28	28
Pluripare	39	39
Total	67	67

Vihet re një përqindje me e lartë tek pluriparet por jo domethënëse. Edhe në këtë rast me një variabel nuk mund te nxirret raporti i riskut.




Figura 12. Paraqitet shpërndarja sipas paritetit e rasteve me prediabet

3.2 Tabelat përshkruese për tremestrin e dytë

Tek keqformimet apo komplikacionët fetale të tremestrin të dytë në shtatzëni diabetike është venë re rritje e rasteve me **anomali te tubit neural** apo **kardiovasulare**, fakt që tregon se niveli i lartë i glicemisë apo i hemoglobinës së glukozuar në gjak ka lidhje te drejtpërdrejte me përqindjen e anomalive të këtij lloji. Gati dy të tretat e anomalive që përfshijnë këto sisteme u përkasin pacienteve me tolerance të dëmtuar të glukozës ose të njohura me diabet. Defektet e tubit neural ndodhin 13 deri në 20 herë me shpesh tek shtatzëni diabetike. Rëndësi të veçantë ka vlera e HbA1c-së. Rritja e saj mbi 8.5 ka treguar një rritje të vlerës së anomalive fetale.

Në tabelat e mëposhtme janë analizuar korrelacionët midis moshës së gruas, paritetit dhe nivelit të glicemisë me anomalite. Numri total i anomalive të regjistruara përgjatë harkut kohor të 27 muajve është 44, por nga këto gjashtë gra nuk e përfunduan shtatzëninë pranë spitalit Durrës.

Për të pasqyruar sa më qarte ndryshimet dhe rezultatët në këtë tremester janë bërë disa krahasime. Rezultatët në fund të këtij tremestri konkludojmë se:

- Nuk ka sinjifikance midis moshës së gruas dhe llojit të anomalive, por me rritjen e moshës rritet probabiliteti për të pasur anomali gjatë tremestrit të dytë
- Gjatë kohës së studimit u vu re se numri më i madh i anomalive nuk korrespononte me grupmoshën kryesore të pacienteve
- Frekuenca më e madhe e anomalive që shoqëron ndryshimet e nivelit të glicemisë në studimin tonë i përket spina bifida.
- Me rritjen e peshës rritet mundësia për të pasur diabet gestacional, rritet mundësia për të pasur anomali të tremestrit të dytë

Tabela 12. Paraqet krahasimin midis anomalive fetale dhe moshës së gruas në kategori

Anomalite fetale	Moshë e femrës			Total	P 0,449 OR 3,666 CI 95% [1,22-5,29]
	<20 vj	20-30	>30 vj		
Kardiake	2	4	7	13	
Sp.bifida	3	7	4	14	
Të tjera	1	6	2	9	
Total	6	17	13	36	

Shohim se me rritjen e moshës së gruas rritet edhe përqindja e keqformimeve kardiake. Nuk ka ndryshime statistike domethënëse midis moshës dhe anomalive fetale (P 0,449), por me rritjen e moshës probabiliteti për të patur anomali fetale rritet 3.6 herë. (Shohim se gjasat për të patur anomali fetale rriten me rritjen e moshës së gruas, Odds 3,6 CI 95%)




Figura 13. Shpërndarja e anomalive sipas sistemeve jetesore te prekura

Në bazë të të dhënave të mbledhura përgjatë kohës së studimit vume re një shpërndarje të tillë në lidhje me grupmoshat të anomalive dhe të ndryshimeve të glicemisë.




Figura 14. Shpërndarja e rasteve me prediabet dhe diabet të kategorizuar sipas moshës




Figura 15. Shpërndarja e anomalive sipas moshës

Sic shihet dhe në grafike kulmi i anomalive nuk përputhet me kulmin e moshë ku shfaqet me tepër ndryshime në glicemi, por shumicën e rasteve e përmbledh grupi i dytë për arsye të numrit me të madh të pacienteve në këtë grupmoshe.

Tabela 13. Paraqet krahasimin midis anomalive fetale dhe paritetit të pacienteve

Anomalit fetale	Pariteti		Total	P 0,215 OR 3,133 CI95% [0,34-5,14]
	Primipare	Pluripare		
Kardiake	4	9	13	
sp.bifida	9	5	14	
Të tjera	4	5	9	
Total	17	19	36	

Nuk vihat re rritje e numrit të keqformimeve kardiake në lidhje me paritetin por ka rritje përse i përket spina bifida. Risku rritet pothuajse me dy herë me rritjen e numrit të lindjeve (shtatzanive të

gruas.) Dhe pse ka ndryshime midis grave primiparë dhe pluripare përsa i përket shfaqjes së anomalive fetale, ky ndryshim nuk është statistikiisht domethënës, vlera është mbi 0,05 (p 0,215)

Tabela 14. Paraqet krahasimin midis anomalive fetale dhe nivelit të glicemisë për tremujorin e dytë

Anomalit fetale	Niveli i glicemisë		Total	P 0.460 OR 1,559 CI95% [0.09-1,98]
	prediabet	Diabet gestacional		
Kardiake	5	2	7	
Sp.bifida	4	3	6	
Te tjera	1	1	2	
Total	10	6	16	

Pacientet prediabetike në tremujorin e dytë kanë 1,6 herë me shumë risk për një fetus me anomali kardiake, ndërsa pacientet diabetike kanë 1,3 herë me shumë risk për të zhvilluar spina bifida krahasuar me pacientet prediabetike. Ekzistojnë diferenca midis grave diabetike dhe prediabetike por këto diferenca nuk janë statistikiisht domethënëse (P 0,460)

Tek të gjitha gratë që dolën me ndryshime të nivelit të glicemisë u bë matja e peshës trupore, Gjithashtu u vu re se të gjitha deklarorin rritje mbi 7 kg të peshës trupore, brenda 4 mujorit të parë të barrës.

Tabela 15. Paraqet krahasimin midis peshës së gruas dhe nivelit të glicemisë për tremujorin e dytë

Pesha e gruas	Niveli i glicemisë		Total	P 0.001 OR 17,116 CI95% [10,19-25,29]
	Prediabet	Diabet gestacional		
Normale	8	2	10	
Obeze	2	4	6	
Total	10	6	16	

Me rritjen e peshës trupore tek pacientet rritet edhe niveli i glicemisë. Ndryshimi i vërejtur midis dy grupeve është statistiki domethënës. (P 0,001). Për tremujorin e dytë pacientet me peshë normale kanë tre herë më pak risk për të patur diabet krahasuar me pacientet me mbi peshë ose obez. Prediabetiket me peshë të madhe, pra obeze kanë gjithashtu një risk të shtuar krahasuar me pacientet prediabetike me peshë normale. Risku rritet me 4 herë. Raporti i gjasave del 17, ndaj konkludojme se *pesha e madhe e gruas është faktor risku i zhvillimit të diabetit.*

3.3 Tabelat përshkruese për tremestrin e tretë

Në këtë fazë të shtatzënisë fetusi ndryshon apo përshtatët në zhvillimin e tij me patologjitë e nënës për këtë trimester. Përveç niveleve të larta të glicemisë, e cila con në makrosomi, organi tjetër më i rëndësishëm i nënës që preket është veshka. Si pasojë tek ajo shfaqen problemet kryesore renale:

- Infeksionët e shpeshta urinare
- Hipertensioni arterial
- Preeklampsia

Patologji të cilat do të shoqërohen me ndryshime fetale të tipit:

- Partus premature
- Hipotrofi fetale
- Ndryshime në sasinë e likidit amniotic

- Kalcifikim te placentës
- Feto-morto in utero

Sipas studimit te bërë në total për repartin e patologjisë së shtatzënisë gjatë tremestrit të tretë (pa përfshirë lindjen) rezultoi se:

- U hospitalizuan 1490 gra gjatë tremestrit te tretë dhe u ndoqën në mënyrë ambulatorë 1945 të tjera përgjatë 27 muajve të studimit.
- Iu nënshtruan 2967 gra marrjes së glicemisë esëll të pakten një herë gjatë tremestrit të fundit të shtatzënisë
- Iu nënshtruan provës së glicemisë 250 raste
- Janë plotësuar me HbcA1 132 raste
- Në grupin e studimit që plotësoi kartelën tip gjatë këtij tremestri me të gjitha kriteret ishin 168 gra. Tek të gjitha u zbatua marrja e glicemisë, matja e hemoglobinës së glukozuar, matja e peshës, ndjekja nga afër e shëndetit amtar dhe zhvillimit fetal. Në këtë grup 63 raste ishin me prediabet dhe diabet gestacional
- Faktor risku për të kaluar diabetin në shtatzëni është anamneza familjare
- Faktor risku në shfaqjen e diabetit gestacional dhe komplikacionëve te tij është pesha e gruas: obeziteti amtar
- Pasojat fetale më të rëndësishme të këtij tremestri nga ndryshimet e nivelit të glicemisë është makrosomia dhe partusi prematur

Patologjitë me të rëndësishme të cilat shfaqen në shëndetin e gruas shtatzënë gjatë tremestrit të tretë janë vendosur në tabelën e mëposhtme si dhe janë paraqitur në mënyrë grafike duke krahasuar hospitalizimin me shërbimin ambulator.

Tabela 16. Paraqitet shpërndarja e rasteve të kategorizuara sipas patologjive kryesore

Diagnoza	Hospitalizimet (vendi në P.B.)	Përqindja	Ambulator
Preeklampsia	206	21%	154
Partus premature	344	42%	286
Infeksion urinar	104	13.4%	96
Gravidanc serotine	48	4%	12
Hipotrofi fetale	93	4%	32




Figura 16. Shpërndarja e patologjive sipas trimestrit të tretë

Pas përpunimit statistikor të të dhënave për grupin prej 168 pacientesh që u plotësuan me të gjitha ekzaminimet, ekografinë dhe monitorimet u nxorrën përfundimet e mëposhtme në lidhje me:

3.3.1 Tabelat përshkruese mbi ndikimi e anamnezës familjare

Tabela 17. Paraqet krahasimin midis nivelit të glicemisë për tremujorin e tretë dhe anamnezës për diabet

Niveli i glicemisë	Anamneza familjare		Total
	Jo	Po	
Prediabet	27	14	51
Diabet gestacional	3	13	16
Normal	101	0	101
Total	140	28	168

1. Lidhja midis anamnezës dhe glicemisë është e dukshme. Ka ndryshime midis diabetikëve dhe prediabetikeve sa i përket anamnezës familjare, $p < 0,01$.
2. Pacientet me anamnezës familjare për diabet kanë gjasa për të zhvilluar diabet krahasuar me ato paciente që nuk kanë patur histori familjare të diabetit.

3.3.2 Tabelat përshkruese mbi ndikimi i paritetit në zhvillimin e diabet gestacional

Tabela 18. Paraqet krahasimin midis paritetin dhe nivelit të glicemisë për tremujorin e tretë

Niveli i glicemisë	Pariteti		Total	P 0.105 OR 4.5 CI95% [1,17-4,92]
	Primipare	Pluripare		
Prediabet	25	24	49	
Diabet gestacional	5	8	14	
Normal	60	36	96	

Total	100	68	168	
-------	-----	----	-----	--

1. Primiparët janë më pak të riskuara për diabet krahasuar me pluriparet në tremujorin e tretë të shtatzënisë. Raporti i gjasave 4,5, tregon pariteti përbën faktor ndikimi në diabet.
2. Dhe pse ekzistojnë diferenca midis dy grupeve si për prediabetiket ashtu edhe për diabetiket në tremujorin e tretë këto diferenca nuk janë statistikisht domethënëse. (P 0,105)

3.3.3 Tabelat përshkruese mbi ndikimi i peshës së gruas në shfaqjen e diabet gestacional (grafik)

Kontrolli i peshës amtare u bë tek të gjitha në mënyrë të rregullt me peshimin e përmuajshëm gjatë paraqitjes së tyre pranë kabinët të tonë. Në grupin obez u përshinë të gjitha pacientet që e nisën shtatzëninë e tyre me peshë të lartë (IMT mbi 30 %) si dhe ato që shtuan gjatë muajve të shtatzënisë mbi 25 kg.

Tabela 19. Paraqet krahasimin midis nivelit të glicemisë për tremujorin e tretë dhe peshës së gruas

Niveli i glicemisë	Pesha e gruas		Total	P 0.001 OR 30.3 CI95% [1,11-32,18]
	normal	Obez		
Prediabet	35	14	49	
Diabet gestacional	5	9	14	
Normal	92	3	95	
Total	132	26	168	

1. Me rritjen e peshës trupore tek pacientet rritet edhe niveli i glicemisë. Ndryshimi i vërejtur midis dy grupeve është statistikisht domethënëse. (P 0,001)
2. Për tremujorin e tretë pacientet me peshë normale kanë 1,7 herë me pak risk për të patur diabet krahasuar me pacientet me mbi peshë ose obez.

3. Prediabetiket me peshë të madhe pra obeze kanë një risk më të ulët krahasuar me pacientet prediabetike me peshë normale. Risku rritet me 2,7 herë. Raporti i gjasave mbi 30 flet qart për ndikimin që ka pesha në shfaqjen e diabetit.




Figura 17. Paraqitja e rasteve me obezitet në krahasim me peshën normale në tre kategorizimet

3.3.4 Tabelat përshkruese mbi ndikimi i paritetit tek komplikacionet fetale

Kjo lidhje u kërkua për disa arsye:

- Popullata që ka numër të shtuar lindjesh është e nivelit të ulët socio-ekonomik. Këtu flasim për mbi 4 lindje.
- Janë me pak të kontrolluara gjatë shtatzënisë së tyre
- Nënata kanë moshë relativisht mbi 34 vjeç.

Tabela 20. Paraqet krahasimin midis paritetin dhe komplikacionëve për tremujorin e tretë

Pariteti	Keni patur komplikacione		
	Po	Jo	Total
Primipare	21	79	100
Pluripare	11	57	68
Total	32	136	168

Ndryshimet midis pluripare dhe primipare nuk janë statistikisht domethënëse, P 0,4. Gjithashtu numri i shtatzënive nuk përbën faktor risku për zhvillimin e komplikacioneve, Odds 0,6. CI95% [1,57- 3,3,3].

3.3.5 Tabelat përshkruese mbi ndikimi i moshës së gruas tek komplikacionet

Duke qenë se për arsye të jetës sedentare shumë gra me kalimin e kohës ndryshojnë mënyrë jetese si dhe dietë ushqimore, u bë kjo ndarje për të parë nëse kjo do të kishte lidhje me ndryshimet e glicemisë gjatë shtatzënisë së tyre.

Tabela 21. Paraqet krahasimin midis moshës së pacienteve (në kategori) dhe komplikacionëve për tremujorin e tretë

Moshë e femrës	Keni patur komplikacione			P 0.66 OR 0.8 CI95% [0,18- 1,37]
	Po	Jo	Total	
<20 vj	8	22	30	
20-30	14	84	98	
>30 vj	10	30	40	
Total	32	136	168	

1. Edhe pse ka dallime midis moshës dhe komplikacionëve por këto dallime nuk janë statistikisht domethënëse.
2. Edhe raporti i riskut flet që mosha nuk përbën faktor risku në shfaqjen e komplikacionëve në tremestrin e tretë

Përveç kërkimeve që u bënë me grupin e pacienteve të ndjekura korrektësisht me planin e veprimit për të nxjerrë një përfundim sa më domethënës përse i përket shtrirjes së këtij problemi dhe në popullatën normale u morrën parasysh dhe statistikat e spitalit Durrës në klinikën e patologjisë së barrës për frekuencën e të njëjtave patologji. U studiua paralel me këto të dhëna edhe shtrirja që kishte GD tek çdo patologji e tremestrit të tretë (të hospitalizuara të paktën një herë) dhe u vune re këto të dhëna.

Tabela 22. paraqitja e të dhënave mbi frekuencën e diabetit gestacional tek çdo patologji barrë

	Total	GD dhe prediabet	Te tjera	Grupi i studimit
Preeklampsi	206	72	144	60
Patologji barre *	648	57	591	15
Partus prematur	344	34	310	12
Hipotrofi	125	15	110	4
Polihidramnion	30	9	21	7
Infeksionë urinë	140	30	110	22

